



05/08/2025
02/225



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -II- (dytë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt e mbajtur me datë:10.03.2025.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/226 datë:11.04.2025 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin fiskal 2025.
3. Shqyrtimi i Raportit 3 mujor Financiar janar-mars për vitin 2025.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-plani i veprimt tre vjeçar për banim social 2025-2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kuvendit për vitin 2024.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2024.
7. Formimi i Këshillit Organizativ për kremtimin e 16 Qershorit , Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/523 datë:02.05.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, (qëllime të tregut publik) dhe interesit publik , në zonën kadastrale në Carrallukë, Malishevë.

9. Formimin e Komisionit vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, (qëllime të tregut publik) dhe interesit publik , në zonën kadastrale në Carrallukë, Malishevë.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/333 datë:17.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, përfundimi i procedurës së këmbimit të pronës publike me pronë private, sipas vendimit të Kuvendit nr.02/397 datë:11.09.2024.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/369 datë:27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për inicimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publike, në komunën e Malishevës.
12. Formimi i Komisionit në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publike, në komunën e Malishevës.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/362 datë:27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për shqyrtim të mëtejme të kërkesës nr.01/350 datë:21.03.2025.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Komitetit për arsim, kulturë rini dhe sport për vitin 2025.
16. Shfuqizimi i vendimit nr.02/478 datë:10.01.2025, për miratimin e Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/85 datë:07.04.2025, e parashtruar nga Organizata e Veteranëve të luftës së UÇK-së) dega në Malishevë.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/166 datë:02.04.2024.
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/25 datë:25.02.2025.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/35 datë:28.02.2025.
21. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/84 datë:02.04.2025.
22. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/94 datë:14.04.2025.
23. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/118 datë:05.05.2025.
24. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajtë me datë: 15.05.2025 dhe filloi në ora: 10:45. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 24 asambleistë, Drejtori për bugjet dhe financa Blerim Thaçi, Fadil Shala- Zyrtar në Drejtorin për shërbime publike, Drejtori inspektoriatit Hafir Rexha, Drejtori për urbanizëm Avdi Morina, Drejtori për Bujqësi dhe pylltari Syl Dukolli, Drejtori për Gjeodezi Bashkim Krasniqi, Sabit Berisha- përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit, përfaqësues nga KDI, përfaqësues nga LMT dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesusi i Kuvendit Komunal të Malishevës z. Argjend Thaçi.

Kryesusi i Kuvendit-Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Prezent jemi 24 anëtar, kemi kourum dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. A ka dikush të diskutojë jashtë rendit të ditës?

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma socialdemokrate): Përshëndetje për të gjithë!

Unë dua ta shprehi një shqetësim që ka të bëjë me një kontrat publike për qështjet e mbulimit të shpenzimeve të varrimit, që është kontrat e lidhur në mes Komunës së Malisheës dhe këshillit të bashkësis Islame në Malishevë. Ne si kuvend me këtë legjislatur me propozim të Kryetarit të Komunës kemi marr një vendim që Komuna e Malishevës të i mbuloj shërbimet e varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës. Ne si Kuvend kemi vendosur dhe kritere, qmimin, dhe ja kemi dhënë lejen Kryetarit të Komunës që të lidh kontrat me këtë operator ekonomik. Në atë vendim ne kemi marrë vendim që shërbimet e varrimit të përfundohen për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës pa dallime etnike, qytetare apo qfarë do qofshin ato. Mirëpo në praktik kjo kontrat nga operatori ekonomik në mënyr sistematike është shkelur, sepse është kushtëzuar në pagimin e antarësis ndaj këshillit të bashkësis islame në Malishevë. E përdorin këtë llojë të kushtëzimit në mënyr që qytetarët të paguajn anëtarësin e pastaj me ju kry shërbimet e varrimit. E kam ndëgjuar një rast që më ka prekur shumë në fshatin Senik, vdes një i moshuar i cili ka jetuar në kushte të rënda ekonomike, jetonte vetëm me fëmijën e vet i cili po ashtu ishte me nevoja të veqanta. Kur përfaqësuesit e fshatit shkojnë në KDI për me lajmëruar rastin për me i kry shërbimet e varrimit sipas kontratës, ata e cekin që personi në fjalë nuk ka paguar anëtarësi prandaj ne nuk mundemi me ja përfundu shërbimet pa i përfunduar pagesat e anëtarësis. Përmes një kontrate publike kushtëzohet qytetari me u bërë anëtarë i këshillit të bashkësis islame, gjë që është një shkelje drastike dhe një diskriminim i qartë ndaj qytetarit të kësaj Komune. Ai është operator ekonomik i kontraktuar dhe duhet të i kryej këto shërbime. Ka njerëz që nuk i përkasin ndonje fesë, mirëpo shërbimet e varrimit Komuna e Malishevës i kryen për të gjithë qytetarët e Malishevës. Kërkoj prej ekzekutivit dhe pse e di që Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e shërbimeve publike që e menagjon këtë kontrat janë marrë me këtë punë i kanë dhënë vërejtje, kërkoj publikisht dhe nga operatori ekonomik që të i kryej shërbimet e varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës konform kontratës të cilën e ka me Komunën e Malishevës. Nëse vazhdon ai operator ekonomik me i kushtëzu qytetarët e Malishevës me qështjen e pagesës së antarësis unë ka me kërkuar para jush me formu një komision hetimor. Përveq diskriminimit qytetarë, dhe shkeljes së kontratës të cilën është duke e bërë, këtu ka dhe elemente të veprës penale, sepse përmes kontratës publike po i kushtëzon njerëzit me u bërë me zor anëtarë të komunitetit tënd. Unë personalisht nuk kam ndonjë ngarkes në lidhje me atë operator, sepse dhe unë jamë anëtar i këshillit të bashkësis islame, dhe unë paguaj anëtarësi. Kjo nuk më bënë mua të heshtur që unë me i mbrojtë ata kur bëjnë diskriminim ndaj qytetarëve të Komunës së Malishevës. Kërkoj që të mirren masa konform ligjit nëse nuk marrin masa ata unë do të dal në

seancën tjetër prap këtu dhe përveq që do të kërkoj ndërprerje të kontratës do të kërkoj dhe rast hetues, sepse këtu ka dhe elemente të veprës penale sipas opinionit tim.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Mirë që e ngriti këtë qështje Halili dua ta pys kush është ky operator ekonomik dhe a është i lidhur me ndonjërin prej imamit? Po ashtu një rast puntorëve që i hapin varrezat ju është kërkuar nga familja që të ju paguhet dreka. Është e pandershme nëse një imam kryen ksi shërbime të tilla dhe bënë kësi lloj probleme të tilla.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Veton dhe ti ke qenë i pranishëm kur kemi marrë vendim, Kuvendi Komunal ka marr vendim që shërbimet e varrimit me ja dhënë operatorit ekonomik Këshilli i bashkësis islame në Malishevë, institucionit jo individëve dhe institucioni e kryen atë punë. Mirëpo këtë lloj kushtëzimi nuk ja bënë askush tjetër përveq këshillit, sepse kur të vdes dikush shkon dhe e lajmëron te këshilli i bashkësis islame dhe ai thot që ti nuk ke paguar e kushtëzon me pagu antarësin.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Përshëndetje për të gjithë! Dua ta ngris një qështje sa i përket një neglizhencës të një departamenti të caktuar. Të gjithë jemi dëshmitar që në shkollën “Ibrahim Mazreku” kanë bërë disa investime të cilat janë përmes fondit për efqens, ku është rregulluar objekti i shkollës, mirëpo prej përfundimit të atyre punimeve materialet e demoluara kanë mbetur mbrapa shkollës përkatësisht te pjesa e parkingut që është shfrytëzuar nga mësimdhënësit. Ka kërkesa të vazhdueshme që me i largu ato mbetje, që ajo pjesë të shfrytëzohet për parking dhe të trajtohet qështja e ambientit rreth shkollës. Kryetar nuk e di qka ka ndodhë por kam parë një ndryshim pozitiv të qështjes së mbeturinave, jemi duke e parë një angazhim më të madhë të Kompanis sa i përket pastrimit të rrugëve në qytet. Janë shtuar disa paisje të cilat nuk kanë qenë më herët por po e dhëjnë atributin e vetë në aspektin e pastërtisë në qytet. Inkurajoj që të mbështet sa më shumë kompania sa ka mundësi Komuna që qyteti i Malisheës me qenë sa më i pastër. Por duke mos u fokusuar vetëm në qytet por dhe në fshatra.

Qështja e sheshit në Malishevë, për me u përfundu një punë duhen disa gjëra me u demulu pastaj me u rregullu. Qështja e procesit të punimeve konsideroj që është duke shkuar më shpejt sesa është parapa në kontrat, këto punime janë duke ja dhënë një pamje krejtësisht tjetër Komunës së Malishevës përkatësisht qytetit. Sipas premtimeve të Drejtorit të Urbanizmit mbrenda muajit Qershor ka thënë që të paktën segmentet e rrugëve kan me qenë të qarkullueshme. Urojë të ndodhë mbrenda muajit Qershor sepse fillon dhe sezona e verës dhe lehtëson qarkullimin e bizneseve dhe qytetarëve.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Përshëndetje për të gjithë!

Qështja e projektit të ndërtimit të sheshit, dua të di Drejtor a ka pasur devijime nga projekti paraprak, nëse po në cilat pika dhe përse ka ndodhë?

Kryetar ne e dim që Komuna e Malishevës për vite me radhë është përball me qështjen e rriqrave, në vitet paraprake e dimë që spërkatja është bërë në faza të ndryshme e cila ka filluar më herët se kur ka filluar sezona ku janë aktive dhe problematike. Këtë vitë nuk kam parë ende që ka filluar diqka e tillë, a ka ngecje një gjë e tillë, kur pritet me fillu si kontrat dhe zbatimi në teren i spërkatjeve të zonave endemike.

Gjatë këti muaji i kam parë që janë vendosur numrat e shtëpive në fshatra, mirëpo kam parë që vendosja e numrave nuk është bërë në mënyrën e duhur, nuk është bërë në renditje të duhur.

Kishte qenë mirë që kushdo që e ka bërë këtë renditje me bërë në mënyr të duhur.

Qështja e subvencioneve në bujqësi gjatë fushatës kamë parë që keni nda disa paisje bujqësore, mirëpo nuk kam mundur me pa se ku kanë qenë ato shpallje publike.

A është përdor kjo më shumë si fushatë elektorale apo si ka shkuar?

Shpallja në Prokurorim publik i një tenderi për ndriqim publik e kam parë një kërkes që ka qenë shuma shumë e lartë. Shumë marramendëse për një Komunë si Malisheva dhe e dimë që në pjesën më të madhe të fshatrave është ndriqimi publik. Sa ka pasur nevojë Komuna jonë me pas një kontrat të tillë të shtrejtë kur ka mundur vetëm mirëmbajtje ose ndërrim të her pas hershëm. Kemi pasur një kontrat 3 vjeqare kur ka fillu shumë më lirë 150,000.00-200,000.00E përse kemi pasur nevojë për një kontrat kaq të lartë.

Qështja e kabinetit tuaj Kryetar ne e dimë që prej vdekjes së Drejtorit të shëndetësis nuk është plotësuar kjo pozitë. Përse ka ndodhur kjo? Po ashtu ish Drejtoresha e arsimit ka kaluar në pozitë tjetër si deputete a e keni plotësuar si proces a dëshironi me shku me ushtrues detyre apo si e keni parapa?

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëlinda Gashi!

Mirëlinda Gashi (asambleiste e pamvarur): Përshëndetje për të gjithë!

rruga që lidh shkollën fillore, gjimnazin dhe shtëpin e shëndetit tranzitit, është rrugë me rrezikshmëri të lartë. Trotuarët në atë pjesë janë të bllokuar, qdo ditë atë rrugë e frekuentojn fëmijët dhe familjarët të cilët i dërgojnë fëmijët në shkollë. Mundësisht në atë rrugë me marrë masa me bërë një zgjidhje. Ato kompani të cilat janë duke ndërtuar me vendos ndonjë shej të rrezikshmëris, sepse duhet me pas dhe distancën sa metra larg me qenë objekti. Asnjëri objekt nuk kam parë që kan vendosur shenja të rrezikshmëris.

Te shkolla Ibrahim Mazreku kërkoj që në oborrin e asaj shkolle te hyrja të vendoset një ramp. Policin e falenderoj shumë se janë shumë aktive në atë rrugë po thuajse qdo ditë gjatë orarit të procesit mësimor i kemi prezent, sepse dhe ata po e kuptojnë që ajo rrugë do të sjellë një rrezik shumë të madh.

Rrugët në fshatra, po thuajse në qdo fshatë rrugët janë të dëmtuara nga vetë natyra po ashtu po dëmtohen prej qytetarëve të cilët po i prejn dhe po i lëjnë në atë gjendje. Kisha kërkuar me u kriju një komision të paktën ato rrugë të cilat janë shumë të dëmtuara të i rregullojnë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Përshëndetje për të gjithë!

Me vëmendje e dëgjova kolegun tim për punën e bashkësis islame të Komunës së Malishevës, dhe unë kam hasur në raste të tilla që bashkësia islame nuk është duke u sillur konform mandatin të vetë është duke dalur jashtë kornizave të veta. Sa di unë këta operojnë sipas dëshirave të tyre

nuk kanë ndonjë normë juridike që i përcakton saktë se si duhet të veprojnë. Kisha pas dëshirë me ditë a ka ndonjë normë apo ligj që i përcakton saktë veprimtarinë e bashkësisë islame? Në këtë rast më së shumti po pëson qytetari. Ne si fshat kemi paguar anëtarësi në gjatë të Maralis, një vit pasi kemi kaluar që është ndërtuar gjatë në fshatin Lumishtë menjëherë e kanë ndërpre nuk ka marrë pjesë hogja i Maralis në ceremoni të vorrimit dhe as për ngushëllime. Janë duke i keqpërdorur institucionin e bashkësisë islame. Me rregull këtë qështje mos të dëmtohen qytetarët më shumë.

Një shqetësim tjetër lidhur me qështjen e arsimit, kur është emruar drejtoreshë Arbëresha Krasniqi e kam uruar dhe i kam thënë që kam besimin që si femër me energji pozitive do të punojë në arsim, mirëpo nuk kaloi kohë e gjatë kam dalë dhe e kam shprehur shqetësimin dhe zhgënjimin tim. Konsideroj që prej mbas luftës deri në këto momente që po flasim gjendja në arsim si sot nuk ka qenë asnjëherë. Gjithqka është jashtë kontrolli Drejtorët e shkollave nuk qëndrojnë në shkollë asnjë ditë, paramendoni kur Drejtori nuk është prezent në shkollë qka bëjnë arsimtarët. Kam qdo ditë ankese të mësimitdhënësve në Malishevë nuk kanë fotokopje, nuk kanë ku ta bëjnë një shkresë mungojnë gjërat elementare. Këto shqetësime i kam bërë të Drejtoreshës ka thënë që është një marrëveshje në mes ministrit të Arsimit dhe ata nuk janë serioz nuk e implementojnë. Nuk më intereson se qfarë thotë ministria e arsimit, sepse ministria e arsimit nuk mundet me ma rregulluar mua gjendjen në shkollën e fshatit tim dhe Komunës tonë, ne jemi përgjegjës me rregullu qështjen, nëse ata na neglizhojnë ne duhet vetë me shiku me rregullu me gjatë një zgjidhje.

Një pyetje e kam për Drejtorin e Urbanizmit gjendja e kolektorit të ujërave të zeza, e di që i kemi nda 450,000.00E, a është duke u implementuar si projekt? Në cilën fazë kanë arritur punimet e këtij kolektori?

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit Lima!

Hamit Lima(anëtar nga LDK): Përsëritje për të gjithë!

Halili filloj diskutimin për bashkësinë islame, sa kam informata fshati Senik nuk ka imam dhe kanë mundur me i thënë me ardhë me paguar antarësin për arsye se imami është pa kontrat. Unë kërkoj mos me u ndërpre kjo kontrat sepse është e mirë për qytetarët me i përfundu procedurat e vorrimit. E ceki halili shkeljen e vendimit merrnu me shkeljen e vendimit të cilin e ka bërë Drejtori, a e ki vendimin e shisha barev a është duke u zbatuar jo as një përqind. E ki vendimin për mbeturina inerte a është duke u zbatuar jo. Ky mirret me shantazhe mundohet me i shantazhu njerëzit, me i njollos njerëzit por nuk mundet.

Kryetar unë kam informata investitorit të ndërtimeve të larta e sjellin projektin në Komunë për me bërë një ndërtim e sjell projektin dhe nuk ja pranoi, i vendosni kusht me u bërë prej planit të Komunës. A është e vërtetë kjo?

Unë kam shprehur shqetësim dhe më herët për shtëpinë e shëndetësisë Urimi i vendoske disa foto u hap bunari, a është bërë QKMF-ja me ujë apo është bërë vetëm për foto?

Kryetari i fshatit të Banjës kam kërkuar nga Kryesusi i Komisionit me shkarku atë nga detyra sepse nuk ka të drejtë me qenë dhe Kryetari i partis dhe Kryetari i fshatit. Nuk e përfaqëson fshatin ai, qfarë të drejte ka si kryetar i fshatit me më thënë pikë të rendit të ditës parcelën numër kaq me ja falë gjatë në Banjë. Qfarë të drejte ka Kryetari i fshatit me u marrë me këtë punë?

Kërkoj që të mirresh me këtë punë ta lirojë njëren pozit sepse ai nuk e ndihmon fshatin por e dëmton.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valjetë Hoti!

Valjetë Hoti (anëtare nga PDK): Kryetar, përse nuk ka bursa dhe këtë vit për student?

Valoni i ceki mbeturinat por më shumë në formë përgëzimi për kompanin dhe punën që po e bënë këtu në qendër, mirëpo për mbeturinat për gjatë rrugëve kryesore a ka me u ndërmarr ndonjë gjobë ndëshkuese. Letë mbetet hudhja e tyre në ndërgjegjien e këtyre që po i hudhin mbeturinat por me pastrimin dhe grumbullimin e këtyre kush me bërë.

Qështja tjetër është qenët endacak, e di që është problem në gjithë Kosovën e di që sa her e cekim ka qenë e njëjta përgjigje, mirëpo kësaj here kërkoj prej teje që si komunë, si zot shtëpie me ndërmarr masa ndoshta në bashkëpunim me ndonjë shoqat, në bashkëpunim me qytetarët dhe veterinerët që nëse jo me pas si Komunë një strehimore, të paktën me qenë të vaksinuar.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo): Unë kam një pyetje për ju Kryesus dhe anëtarët e Komisionit për zgjedhjen e Kryetarëve të fshatrave. A janë legjitim Kryetarët e fshatrave? Sepse ata veprimtarit i ushtrojnë si të tillë. Përse nuk është votuar ky raport në Kuvend, dhe a do të kompenzohen për kontributin e tyre në aspektin material? Derisa të votohet raporti në kuvend ata nuk janë kryetar të fshatrave fare.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina (anëtar nga LDK): Dëshirova ta shpreh një shqetësim në lidhje me Hidroregjionin. Të gjithë e dimë që Komuna e Malishevës dhe Hidroregjioni e kanë një bashkëpunim për mirëmbajtje të ujrave të zeza, por kompania është papërgjegjëse ndaj kësaj kontrate. Ju e dini që në Astrazup rruga "Fazli Morina" e cila është në implementim për të shtruar asfalt, aty ka pasur me u instaluar dhe gypi i ujsjellsit dhe kanalizimit, kur ka bërë ndërhyrje Komuna në atë pjesë është dashur të ndërhyjë dhe kompania e Hidroregjionit por atë nuk e ka marrë përsipër. E dini që tarifa për mirëmbajtje është rritë është bërë 5 euro, edhe nëse nuk je i kyqur fare në hidroregjion ne si qytetarë kemi paguar atë tarifë. Qfarë marrëveshje ka, përse nuk merr masa apo nuk ju përgjigjet kërkesave të qytetarëve?

Ajo të gjithë fajin e aludon te Komuna, nëse Komuna është përgjegjëse ta dimë a me u drejtu qytetari te institucioni Komunal apo te Hidroregjioni, pagesën e bënë qytetari për mirëmbajtje të ujrave të zeza dhe punët nuk i kryen kompania.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Së pari dua ta korrektoj Albanin sepse unë nuk ngrita një shqetësim për mënyrën si funksionon ai institucion, për kompetencat e tij për organizimin. Unë ngrita vetëm një shqetësim në raport me këshillin e bashkësisë islame në raport me kontratën të cilën e ka me Komunën, kërkoja që ajo kontratë të zbatohet. Shqetësimet e tjera të cilat i ngriti Albani ato janë legjitime ja vlenë me u diskutu, sa e di ligji për fe ende nuk është votuar.

Atë që e ceki Hamiti, është mirë atë që e thotë në mënyrë publike me pas shumë informacione, apo

nëse dëshiron me ju drejtu dikujt duhesh me ndëgju mir se qka ka thënë. Mua më intereson me respektu vendimin tim, vendimi im është vdes një qytetar i Komunës së Malishevës ti ki me shku me ja hap varrin, sepse paguhesh 300E për atë punë, pa marrë parasysh a është i besimit islam apo jo. Unë nuk kërkoja me u shkëput kontrata, unë kërkoja me u respektu kjo kontrat. Me dalë dhe me i akuzu ekzekutivin dhe Kryetarin e Komunës që nuk po i liron hapsirat publike, tregoma një Komunë në Kosovë që ka pasur guximin me i liru hapsirat publike siç e ka bërë Komuna e Malishevës dhe Kryetari Kastrati. Të gjithë qytetin është duke e rrënuar dhe është duke i liru hapsirat publike. Kur të përfundohet qyteti do të vazhdojmë punimet dhe do ti lirojmë dhe hapsirat publike në fshatra.

Me dalë me thënë arsimi në Komunën ton kurr nuk ka qenë më keq se sot, është Komuna e parë në Kosovë që më së shumti ka ndërtuar shkolla kjo është detyra jonë. Normal që është detyr e Drejtoris së arsimit ekzekutivit me i monitoru shkollat, mësimdhënësit, Drejtorët, nxënësit të gjithë. Mirëpo sa her ngritet qështja e arsimit nuk është shqetësim vetëm në Komunën e Malishevës është shqetësim dhe problem në të gjitha Komunat e Malishevës.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo): Pasi u cekë nga Kolegu legjislatura e kaluar dhe unë kam qenë pjesë e Komisionit kur është bërë marrveshja me Këshillin e bashkësis islame, ne duhet me kuptu që dhe atëher ka pasur probleme, mirëpo duhet me kuptu fatkeqësisht se bashkësia islame nuk e njohin Kryetarin e tyre. Kështu që ndoshta disa kolegë kanë informacione vetëm nga ai kampi opozitar që në një far forme janë duke e sabotuar bashkësin islame. Është mirë me marrë informacione nga Kryetari i bashkësis Islame sepse ai është legjitim i zgjedhur.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Përshëndetje për të gjithë!

Këtë qështje e ngriti Halili me të drejtë dhe e kemi me obligim me ja sqaruar qytetarëve, askush nuk të kushtëzon me u bërë anëtar i bashkësis islame por qështja është te pagesa, sidomos zgjedhjet e fundit kur janë bërë në bashkësin islame ka gjami e cila vendimi pagesa për anëtar familje është 3euro. Mirëpo kjo kryesi e cila ka ardhë ka kërkuar që anëtarin që secili nga ne e paguan, me pagu përmes bankës. Ky vendim i bashkësis ka ardhë në kundërshtim te disa gjami dhe nuk janë pak, askush nuk të kushtëzon me qenë musliman apo katolik, ky është kushtëzimi i pagesës përmes bankës. Kjo është qështje e cila duhet me u rregulluar nga bashkësia Islame. Qështja tjetër e cila u ngrit nga Hamiti, një prej rregullorëve më të veqanta që ka bërë ky legjislacion Kryetar i Komisionit kam qenë unë, ka qenë rregullorja për bashkësin lokale, e përfaqësuar prej të gjitha partive. Është për qudi nga raportet e para dhe të veqanta në këtë asamble nuk ka ardhë me u shqyrtu, dhe me plot të drejt ngriten shqetësimin kolegët e mi parafolës. Nuk ka më Kryetar fshati, ka bashkësi lokale që ju ka rrit përgjegjësia sepse i përfaqëson tri fshatra, dhe ai që vepron në teke të veta dhe me inate politike nuk e ka vendin aty, sepse nesë e lexon rregulloren ceket që nuk duhet të ketë post politik. Kryetarët e bashkësive lokale nuk janë votuar në këtë kuvend dhe nuk janë legjitim, raporti është dashur me u votu këtu dhe me marrë legjitimitetin.

Një pyetje për Drejtorin Avdi në këtë kuvend i kemi votuar disa parcela të cilat i kanë kërkuar pjesë në shfrytëzim për renovim të trafave, në atë vendim nuk ka qenë pjesë Kijeva tani është

zhvendosur në oborr të shkollës fillore. Sa procedur janë ndjek, mbi bazën e kujt? Për arsye se ende ne kemi fshatra që nuk kanë ndriqim publik, në Kijevë nuk ka ndriqim. Kam bërë kërkesë kjo është e votuar prej vitit 2015 për 4 drita dënohen qytetarët përse nuk i përkasin një subjekti politik, kjo është marrë jemi në vitin 2025 dhe ende nuk është ndërmarr asgjë. Tani e cekni kontrata për mirëmbajtje të ndriqimit 1,600,000,00E shikoni në qfarë lluksi jemi duke jetuar. Një pyetje për Drejtorin Bashkim Krasniqi e kam parë një njoftim për rindërtimin e kadastrit dëshirova të di a është e gjithë komuna e cila ka probleme me pronë, apo janë vetëm disa fshatra të cilët ju i keni cek?

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ajo që po them unë qështja e antarsis me qështjen e shërbimit të varrimit të cilën e paguan Komuna janë gjëra të ndara, nuk guxojnë me u lidh. Mirëpo lidhja e antarsis bëhet për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës nuk ka të drejt me kushtëzuar qytetarin me kontrat publike të Komunës.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Në këtë pjesë e konsideroj debatin e mbyllur jashtë rendit të ditës. 23 anëtar jemi prezent kemi kourum për vazhdim të seancës. për të gjitha këto pyetje dhe shqetësime të cilat u ngritën ftojë Kryetarin dhe kabinetin qeveritar për të ju përgjigjur.

Urdhëro, Kryetar Ekrem Kastrati!

Kryetari i Komunës së Malishevës- Ekrem Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit për punën dhe angazhimin tuaj që po e bëni këto ditë, mandati është i tillë që të i ngrisim qështjet,problematikat, nevojat të cilat i kanë qytetarët e Komunës së Malishevës.

Pika e shërbimit të varrimit është një prej shqetësimeve të cilat ka ardhë nga qytetarët ku vendimi që është marrë në këtë asamble për shërbime të varrimit ka hasur në deformitete të ndryshme. Por kemi angazhuar menagjerin e kontratës dhe drejtorinë përkatëse, mirëpo do të kemi takim dhe me këshillin e bashkësisë islame dhe do i kemi parasysh të gjitha këto vërejtje dhe shqetësime të cilat u cekën këtu në asamble, edhe në rast se zgjidhja e fundit të jetë dhe shkëputja e kontratës me këto rekomandime të juaja të cilat u bënë sot.

Materialet të cilat i keni pasur në shkollën Ibrahim Mazreku, kompania e cila i ka kryer këto shërbime ka kërkuar një kohë që të i largoj këto mbeturina dhe besoj që ajo kohë ka ardhur dhe besoj që shumë shpejt do të mirret me largimin e tyre.

Plani dinamik i punës së sheshit të dëshmorëve kompania e cila është duke i përfunduar këto punime është duke shkuar sipas planit dinamik, besoj që në fund të qershorit përkatësisht në ditën e qirimit të Malishevës të gjitha këto rrugë të cilat i kemi të bllokuara të i kemi në funksion. Projekti është deri në vitin 2026 dhe nuk do mujm ta përfundojmë të gjithë projektin, por rrugët të cilat i kemi të bllokuara të lirohen.

Nebelimi 4 është një kontratë e njohur nga Ministria e Bujqësisë është një kontratë 3 vjeqare, tani sa është kryer faza e parë e këtij viti 2025, që është në konform të luftimit të virusit krime kongo apo epidemis që është karakteristik në Komunën e Malishevës. Deri më tani nuk kemi pasur infeksione nga kjo epidemi, nuk do të thotë që ne do të rrim duar kryq sepse kemi kontratat në vazhdim dhe besoj që të gjitha obligimet të cilat bin ndesh me luftimin e kësaj epidemie do të jenë në funksion të mbrojtjes së shëndetit të qytetarit.

Ndriqimi publik, dhe kjo është një kontrat në organin shqyrtues të prokurorimit publik është njëra prej kontratave që lidhet në mes operatorit ekonomik dhe agjensive kontraktuese, prandaj ajo e ka fjalën e fundit e konstaton ligjshmërinë të drejtën apo jo të drejtën e palëve të cilët pretendojnë të lidhin kontrata.

Drejtori i shëndetësisë dhe Drejtoresha e Arsimit, Drejtorin e Shëndetësisë e ka prek vdekja e hershme, mirëpo na kryqëzon fakti që Drejtoresha e Arsimit tani është pjesë e parlamentit të Kosovës së shpejti ekezkutivi do ta ketë nevojën që të i zëvendësoj përkatësisht me ushtrues detyre do të vazhdojë deri në zgjedhjet e ardhshme.

Sigurimi i qytetarëve me trotuar në zonat e ndërtimit, vërtet është një shqetësim i jashtëzakonshëm që më ka shqetësuar dhe mua, besoj që operatorët ekonomik me sugjerimin e organeve tona që është inspektoriati ta kenë parasysh lirimin e trotuarit në mënyrë që të qarkullojnë lirshëm nxënësit dhe qytetarët. Një pjesë e kësaj është se inspektoriati i punës dhe nuk kemi ne të drejtë të ndërhyjmë te disa ligje të ndërtimit. Ajo që është në kompetencën tonë do ta lusim drejtorin e urbanizmit që të kërkojë nga operatori ekonomik që të i lirojnë hapsirat në të kundërtën do të pasojnë gjrobat.

Renovimi i rrugëve sigurisht kalojë në gjitha rrugët sepse kam angazhime, nuk po kemi mundësi me i rregullu të gjitha, por do të bëjë përpjekje maksimale që kontratën të cilën e kemi për renovimin e rrugëve të jenë të kujdesëshme dhe të reagon aty ku ka nevojë më së shumti.

Te furnizimi në shkollë, jemi në hall shumë të madhe sepse nuk kemi të drejtë ta themelojmë një kontratë për furnizim për fotokopje dhe printer, sepse është autoriteti qëndror i prodhimit publik që menagjohet nga qeveria e Kosovës. Tani ka përfunduar kontrata e këtij operatori i cili ka qenë i pa përgjegjshëm, besoj që në muajin e ardhshëm do të themelohet një kontratë e re, me shpresë që do të zgjidhet një operator ekonomik që është i përgjegjshëm në plotësimin e nevojave jo vetëm të Komunës së Malishevës por dhe të gjitha shkollave.

Projektet në urbanizëm, Hamit ti e ngrite këtë qështje ki njerëz që sjellin projekte të ndryshme dhe me ju besu atyre projekteve ish bërë total rrëmujë. Të gjitha projektet të cilat vijnë këtu duhet të shikohen përmes Drejtorisë së urbanizmit, shikohen se sa janë të mundshme që të realizohen, shqyrtohen, apo të anulohen. Ju kisha lut të gjitha informatat të cilat i merrni nga palët e pa kënaqura me i pa sa kanë bazë ligjore, sa arrihen që dhe ti me qenë në pozitë zyrtare a kishe mundur me bërë atë punë apo jo. Jo vetëm me ngrit një shqetësim sepse shqetësime kemi shumë, por duhet me i pa se a janë të mundshme. Ne kemi me bërë një fushatë zgjedhore, keni me pas rast me i ngrit shqetësimet dhe keni me pas rast me i ngrit vërejtjet te qytetari që mos me na votu apo me të votu ty.

Te bursat, jemi në pregaditje e sipër që këtë vitë të i parashohim bursat për student.

Mbeturinat gjatë rrugëve kryesore, ne kemi pasur një kontratë jo vetëm për mbetura inerte por dhe organike plastike metalit etj. I kemi larguar nga rrugët të cilat i kemi konsideruar si më kryesore por me të vërtetë nganjëherë po na nevojitet një vetëdijësim më i madh nga ana e qytetarëve mos të hudhin mbeturina aty. Po bëjmë përpjekje maksimale e kemi dhe një vërejtje te rruga që shkon për Senik dhe aty do të duhej me reagu, ju kisha lutur që dhe ju kur të keni takim me qytetar me ju tërheq vërejtjen.

qenët endacak është shqetësim i të gjitha Komunave nuk kemi ndonjë strategji të luftimit të kësaj dukurie. Qeveria është në kërkim të një strategjie për arsye se nuk mundën Komunat në mënyrë selektive me luftu këtë fenomen, sepse qenët nuk kanë kufi administrativ, komuna ndoshta i merr

të gjitha hapat me bërë një strehimore por të nesërmen qenët e Komunës së Rahovecit vijnë këtu dhe të mbesin ktu.

Hidroregjioni dhe mirëmbajtja, është njëra prej kompanive me të cilat nuk jemi të kënaqur me punët e saj. Ju e dini sa para kemi shpenzuar në rrjetin e ujësjellsit dhe që e kemi dhënë një kompanie që është përfituese prej investimeve tona. Nuk jemi të kënaqur me punën e tyre, dhe sot parat të cilat janë të qytetarëve ju shkojnë për zhbllokimin e kanalizimeve, ndërsa ata nuk kanë asnjë mjet të vetëm për me hap një kanal me zhblloku, duhet na prap me shku aty për me u marr me kërkesat e juaja dhe nevojat e qytetarëve. Jo vetëm Komuna e Malishevës por të gjitha Komunitat kanë probleme të jashtëzakonshme me kompanit publike sepse nuk menagjohet nga Komuna, menagjohen nga bordet të cilat i zgjedh qeveria.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtori i Bujqësis Syl Dukolli!

Syl Dukolli(Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural): Përshëndetje për të gjithë!

Dua të i përgjigjem pyetjes të cilën e paska bërë në seancën e kaluar deputeti Vetoni, dua të njoftoj që këtë thirrje e kemi në bazë të një memorandumit që e kemi bërë në islamit relief, një organizat që nuk ka bashkëpunuar më herët që ndihmon bujqit në disa Komuna të Kosovës. Kontratën e kemi nënshkruar me datë: 12.09.2024, dhe ju është dhënë mundësia 15 ditë për me apliku të gjithë për me përfitu. Ne kemi qenë pjesëmarrës në buget, ndërsa shpalljet i ka bërë ajo organizat dhe e falenderoj shumë për bashkëpunim, sepse është numri më i madh i serave dhe paisjeve të cilat janë dhënë ndonjëher në bashkëfinancim. Komisioni ka qenë i përbërë dy persona nga organizata, një nga Drejtoria e Bujqësis. Jam unë ai që i kam thënë mos me i publiku rezultatet deri pas zgjedhjeve nuk e kan pasur të lehtë por gjithëpërfshirja ka qenë e jashtëzakonshme. Lista e publikuar e shpalljes së atyre përfituesve të granteve ka qenë me datën: 13.02.2025, 6 ditë ka qenë mundësia me u anku ndonjëri që ka pasur mendim që ka mundur me përfituar prej tyre.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor i Urbanizmit Avdi Morina!

Avdi Morina(Drejtor i Urbanizmit): Dëshirova të ju përgjigjem pyetjes se a është duke vazhduar projekti në bazë të projektit të planifikuar sa i përket sheshit, normalisht që është duke vazhduar si është planifikuar, dhe ne kemi qenë të vetëdijshëm për sfidat dhe problemet sepse siç e dini liri i hapsirave publike nga Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe prona dhe Drejtoria për inspektoriat ka qenë shumë sfiduese e cila ka krijuar mundësi realizimit të projektit të sheshit të dëshmorëve. Normalisht ndonjë ndryshim i vogël mund të jetë në bazë të ndonjë nevojë për të mirë është i pranueshëm, por jo ato të cilat vinë në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Sa i përket vendosjes së numrave të shtëpive ky është një projekt i cili është përkrahur nga agjensioni, mirëpo nuk jemi të kënaqur dhe ne, kemi disa mungesa sepse dhe pse kemi pasur një marrëveshje të përfshihen të gjitha shtëpit në Komunën e Malishevës, kanë bërë disa gabime ku janë rreth 2,000 numra në mungesë. Sa i përket vendosjes së numrave, vendosen në bazë të kriterëve të cilat janë të vendosura, jo në bazë të renditjes. Parashihet që në anën e majt me numra tek, në anën e djathtë të vendosen numrat qift, ndërsa në hapsirat ku nuk ka pasur shtëpi ne kemi lënë numra rezerv. Ky është një arsyetim të cilin na ka dhënë agjensioni. Ne kemi bërë ankes te agjensioni që të përfshihen të gjitha vendbanimet që të i ken adresat sepse është shumë e rëndësishme në këtë kohë të kenë adres.

Albani bëri një pyetje sa i përket kolektorit punimet janë duke vazhduar por ka munges të mjeteve fiannciare besoj që këtë vit me përfundu këtë pjesë dhe i tëri të përfundoj në vitin e ardhshëm.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtori Bashkim Krasniqi!

Bashkim Krasniqi (Drejtor për Gjeodezi dhe kadastrë): Përshëndetje për të gjithë!

Lab është një projekt nga agjensioni kadastral atë që ishe i interesuar ta dish, janë 115 zona në gjithë Kosovën, në secilën Komunë janë dy prona ose tri. Në Komunën tonë janë 4 zona kadastrale që ka të bëjë të gjitha shërbimet të cilat përfundohen te noteri, shërbime që kanë të bëjnë me trashëgimi, dhe shërbimet të cilat kryhen për ndarje dhe regjistrim të gjendjes faktike kryhen nga kjo Kompani. Ata do të vendosen në Malishevë, do ta marrin një zyre përball objektit dhe do të vendosen në zyre të veqanta në qdo fshat që është përzgjedhë si zonë që do të bëhet identifikimi i kadastrit. Nëse projekti tregohet i suksesshëm do të vazhdohet dhe në zona të tjera kadastrale deri të përfundon në gjitha zonat që i kan këto probleme.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Nëse nuk ka askush tjetër vazhdojmë te rendi i ditës ku i kemi disa pika shtesë. Kemi kërkesën nr 01/575, dhe Kërkesa 01/582 të cilat janë kërkesa të Kryetarit.

Kërkesa nr.01/582 ka të bëjë me raportin e punës së Komisionit vlerësues me rastin e udhëheqjes së procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, përmes thirrjes së interesit publik konform vendimit të kuvendit nr02/121 datë 08.03.2024. Pjesë e këtij komisioni është dhe Muharrem Morina i cili është zyrtar ligjor.

Propozojë që të hyjë si pikë e rendit të ditës. Kush është për?

Për: 19

Kundër: 1

Abstenim: 4

Me 19 vota për, 1- Kundër, 4- Abstenime hyn si pikë e rendit të ditës.

Kërkesa tjetër është 01/574, për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të zonës publike lokacioni në të cilin është përcaktuar ndërtimi i deponis së mbeturinave nga ndërtimet dhe demolimet nga objektet ndërtimore në territorin e Komunës së Malishevës, sipas vendimit të kuvendit të Komunës së Malishevës nr.02/2019 datë: 05.05.2022.

Kush është për që kjo kërkesë të hyjë si pikë në rend të ditës?

Për: 19

Kundër: 1

Abstenim: 6

Me 19 vota për, 1- Kundër, 6- Abstenime hyn si pikë në rend të ditës.

Me qenëse hyri si pikë e rendit të ditës kjo pikë është pikë përcjellëse për formimin e Komisionit. Kërkesa 01/575 kërkesë për formimin e komisionit afatshkurtër të pronës publike përmes të procedurës së ankandit publik, përkatësisht të pronës publike në pjesën e njësis kadastrale nr. P-72316001-02053-0 zona kadastrale Banjë në vendin e quajtur Gajrak, tokë pyjore. Në sipërfaqe të përgjithshme prej 166118m² Komuna e Malishevës.

Kush është për?

Për: 19

Kundër: 1

Abstenim: 6

Me 19 vota për, 1-Kundër,6- Abstenime hyn si pikë në rend të ditës.

Kemi dhe një ndryshim të rendit të ditës me kërkesë nga Kryetari i Komunës për arsye të agjendes së tij dhe angazhimeve të pika 6 të zhvendoset dhe të jetë si pikë e rendit të ditës.

Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton zogaj (anëtar nga VV): Nëse kish qenë e mundur dhe kërkesat për ndihmë financiare me u zhvendos menjëherë mbas pikës së Kryetarit. Kishte qenë më mirë pasi që mbesin pa shqyrtu për arsye të pikave të shumta që janë në rend të ditës.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Veton qështja e pikave me qështje pronësore duhet me i pas parasysh se jemi në kohën kur Presidentja mundet me i shpall zgjedhjet, dhe nëse na nxen atë afat neve na bin posht të gjitha këto. Dhe këto janë me rëndësi të veçantë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Shkojmë me votim pikën e 6 me zhvendos të pika 2 kush është për? Me vota unanime miratohet kjo kërkesë.

Kërkesa e Veton Zogaj që pikat 18, 19, 20, 21, 22, 23 të vendosen pas pikës së dytë të rendit të ditës. Kush është për këtë propozim?

Me vota unanime ndryshohen këto pika të rendit të ditës.

Urdhëro Astrit!

Astrit Sertolli (anëtar nga Nisma Socialdemokrate) : Më herët e kam dorëzuar një kërkesë e fshatit Bellanica për bashkim të disa parcellave. Janë afër 9 parcella me i bashkuar me një numër kadastral na duhet për nevojat të Komunitetit. Nëse ka mundësi e kishim shtet si pikë në rend të ditës kërkesën në radhë të parë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kërkesa e Astritit ka të bëjë me një kërkesë të qytetarëve që është kërkesë e arsyeshme legjitime. Kështu që në emër të grupit tonë kërkoj që kjo pikë të futet në rend të ditës.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Nëse pajtoheni e fusim në rend të ditës këtë kërkesë dhe pastaj Drejtori Bashkim na sqaron për mundësinë ligjore dhe hetimin nëse është në rregull.

Kush është për që kërkesa për bashkim të parcellave publike për nevojat të fshatit Bellanica drejtuar Kuvendit Komunal të Malishevës të hyjë si pikë e rendit të ditës?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 22 vota për, 0- Kundër, 3- Abstenime hyn si pikë në rend të ditës.

Kush është për miratim të rendit të ditës me plotësim ndryshime të bëra?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me 22 vota për, 0- Kundër, 5- Abstenime miratohet rendi i ditës.

Pika e parë është shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të kuvendit të mbajtur me datë: 10.03.2025. A ka ndonjë të gjetur që nuk ju është cekur apo ju është shtuar ndonjë gjë.

Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati(anëtar nga PDK): I kisha lut sekretariatën që të fokusohen më shumë në fjalim jo të bëhen copy paste. E pash të nderuar miq nuk ka këtu miq. Është mirë me ja shenu secilit atë qfarë e thotë, përjashtimisht gjuhën jo parlamentare.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Në mbledhjen e kaluar kemi diskutu me sekretariatën qështjen e përshkrimit të procesverbalit, dhe ky proces që ka ardhë tani është i kompletuar në raport me atë që ka ardhë në mbledhjen e kaluar. E përgëzoj administratën e kuvendit që e ka marrë këtë parasysh dhe e ka përmisur.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Shumë faleminderit Valon!

Nëse nuk ka për diskutim më askush, e hedhi në votim kush është për miratim të procesverbalit me vërejtje?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 4

Me 22 vota për, 0- Kundër, 4- Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pauz kthehemi në ora 13:00.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: U rikthye me punimet e pjesës së dytë të pranishëm jemi 23 anëtar të kuvendit kemi kourum për vazhdim të seancës.

Jemi te pika e dytë që është: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Kryetarit të Komunës Janar-Dhjetor 2024. Për prezantim të kësaj pike e kemi të pranishëm Kryetarin e Komunës z. Ekrem Kastrati!

Kryetari i Komunës-Ekrem Kastrati : Të dashur qytetar të Komunës së Malishevës, i nderuar Kryesus i Kuvendit, dhe ju të dashur këshilltar komunal, të gjithë ju të pranishëm. Në mbështetje të ligjit për vetëqeverisje lokale, statutin e punës dhe planin e punës për vitin që e kemi lënë, pas kam nderin që sot para jush e paraqes raportin e punës Janar-Dhjetor të vitit 2024. Ky raport të cilin besoj që keni pasur mundësi ta pranoni të gjithë është një material ku përfshin të gjithë punën një vjeqare, të arriturat e Komunës, por duke mos lënë anash dhe sfidat që së bashku jemi ballafaquar gjatë periudhës që i përket ky raport.

Para se të kalojm te disa pika kyqe të këtij raporti duhet të theksojm që në vitin 2024 si qdo Komunë në vendin tonë ashtu dhe për Komunën e Malishevës ka qenë një vit shumë sfidues për arsye të vazhdimit dhe më tej të krizës me efikacione. Kjo situat po vazhdon me këtë impakt negativ duke dëmtuar në tërësi shoqërin tonë. Pavarësisht kësaj ne si qeveri Komunale në

bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë ju besojmë që ja kemi dalur që me sukses të vazhdojmë realizimin e projekteve të mëdha në të mirë të qytetarëve.

Projekt i veçant për të cilin kemi marrë besimin e qytetarëve përmes procesit demokratik.

Si Kryetar i Komunës jamë shumë i kënaqur me punën dhe suksesin e arritur nga qeverisja jonë e përbashkët me partnerin tonë qeverisës. Jam shumë mirënjohës të gjithë Drejtorëve dhe administratës Komunale që në vazhdimësi kanë qenë të përkushtueshëm të punojnë zellshëm, në mënyrë që qytetarëve të Komunës së Malishevës të ju ofrojmë shërbime cilësore që i meritojnë. Dua të theksoj që në objektivat tona kryesore përveq investimeve në legjislaturën e qytetit, është transparenca dhe llogaridhënia, dhe për këtë Komuna jonë është duke u renditur lartë në raportet e organizatave serioze, që në vazhdimësi bëjnë monitorimin e qeverisjes në nivel lokal. Disa nga fushat kryesore të angazhimit të Kryetarit të Komunës dhe të ekzekutivit në tërësi gjatë vitit 2024 janë:

Bashkëpunimi me qytetarët, investimet kapitale, furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë të pijes, përkrahja e familjeve në nevojë dhe realizimi i planit të punës sipas drejtorive.

Bashkëpunimi me qytetarët ashtu siç vite më parë jemi betuar që qytetarët do të kenë një tretman të domosdoshëm gjatë qeverisjes tonë, si në vitet paraprake jemi angazhuar edhe gjatë kësaj periudhe raportuese të vitit 2024. Qytetarët janë bërë pjesë aktive në qeverisjen tonë ku duhet theksuar se dera e Komunës është e hapur çdo ditë pune për gjithë qytetarët që diskutohet për problemet të cilat na ballafaqojnë dhe shprehin kërkesa të cilët ata kanë në lidhje me përmisimin e kushteve elementare.

Malisheva urbane gjatë këtyre viteve të fundit Komuna e Malishevës është shpallur Komuna më e mirë në vend sa i përket realizimit të bugjetit dhe për këtë një falenderim i jashtëzakonshëm është për ju përkatësisht për këtë asamble komunale. Projekt apo investimi më i madh i Komunës tonë është ndërtimi i sheshit dhe parkingu nëntokësor. Ky projekt po shkon drejt përfundimit dhe besoj që është mrekullia më e madhe e investimeve që po bëhet në funksion të urbanizimit të qytetit tonë. Një punë tjetër e mirë e cila e ka karakterizuar këtë vit është procesi i lirimit të hapsirave publike në zonën urbane, pra po krijohet më shumë hapsirë dhe prona publike po i rikthehet pronarit legjitim për ta shfrytëzuar dhe mbrojtur gjithnjë konform legjislacionit në fuqi.

Furnizimi me energji elektrike, një nga preokupimet më kryesore të qeverisjes tonë komunale që vazhdimisht gjatë vitit 2024 ka qenë edhe zgjidhja e qësjtjes për energji elektrike për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës. Ne si qeverisje e kemi marrë shumë me seriozitet këtë qësjtje, para tri viteve kemi punuar të zhvillojmë takime me të gjitha institucionet relevante, në këtë rast me KEDS dhe ZRRE. Gjatë vitit 2024 ka filluar implementimi i projektit për vendosjen e një kabllu kualitativ, një përquesi të ri elektrik i cili ka ardhë prej SHBA-së dhe për herë të parë është vendosur në qytetin tonë. Implementimi i këtij projekti ka pasur një kosto afro 1,000,000.00E, mirëpo kosto më e madhe ku për ne ka qenë dhe brenga më e madhe gjatë këtij viti ka qenë ajo e reduktimeve të detyrueshme të energjisë elektrike, ku pashmangshëm i ka dëmtuar dhe ekonominë familjare bizneset dhe të gjithë ata të cilët e kanë shfrytëzuar energjinë tonë. Gjatë tetorit është përmbyllur ky projekt dhe Malishevës i është kthyer normaliteti me energji elektrike. Në të njëjtën kohë kemi vazhduar angazhimin sepse fokusi mbetet ndërtimi i një stacioni prej 220kV në Komunën e Malishevës. Faza e parë e hartimit të projektit ka përfunduar dhe jemi në pritje për të vijuar në fazën e tenderimit për të i dhënë një herë e mirë zgjidhje

energjis elektrike.

Furnizimi me ujë të pijës një tjetër angazhim për të cilin qeveria jonë nuk është ndalur gjatë këtij viti. Lidhur me ujin unë ju kam raportuar dhe në seancat e kaluara, siç e dini ne asnjëherë nuk kemi hequr dorë nga kërkesat tona që kjo kërkesë të avancohet dhe qytetarët të kenë ujë të pijës. Ne ju kemi thënë që kemi qenë në kontakt me organizatën „„9,10 min pjesa dyte e cila së bashku me autoritetet komunale kemi dalë me muaj të tërë me par projektin i cili ka qenë i hartuar apo në funksion nga K.R.U Gjakova së bashku kemi ridizajnuar ky projekt ka qenë i mundëshëm por nuk kemi gjetur përkrahje nga qeveria shtetërore për dhënie të kredisë.

Përkrahja e familjeve në kushte të vështira ekonomike sociale, Komuna e Malishevës është një prej Komunave që përmes politikave të saj ka arritur të i del krah një mase të madhe të familjeve të cilat jetojnë në kushte të vështira ekonomike sociale. Si qeverisje Komunale dhe në bashkëpunim me donatorët kemi realizuar këto nisma: kemi përkrahur ndërtimin e dhjetra shtëpive të banimit, kemi bërë hapjen e dhjetra bunarve për familje në nevojë, kemi përkrahur me pako ushqimore qindra familje, kemi përkrahur me mjete finaciare nga kategoria e subvencioneve rastet me probleme shëndetësore ku një pjesë e madhe kanë kaluar përmes jush. Realizimi i projekteve të tjera, kur jemi te projektet e tjera të cilat janë realizuar nga qeverisja jonë Komunale janë të rëndësishme që të i theksoja disa nga ato: Asfaltimi i rrugëve lokale, ndërtimi dhe vazhdimi i trotuarëve në qytezë, ndërtimi i kanalizimit të ujrave të zeza, renovimi i objekteve të shkollave fillore dhe të mesme, ndriqimi publik, investime në arsim, sport dhe kultur, mirëmbajtja e rrugëve lokale, mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ujrave të zeza, po ashtu gjatë kësaj periudhe ka filluar realizimi i një projekti të madh për rregullimin dhe trajtimin e shtratit të lumit nga ura në qendër deri te ura e minitransitit.

Një projekt tjetër i cili është finalizuar së fundi është ndërtimi i tribunës lidore dhe zhveshtoren e stadiumit “Liman Gega” në Malishevë. Po ashtu një tjetër investim që kemi bërë gjatë këtij viti është ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Habib Berisha” që lidhet nga rrethi te Lindi center dhe shkon deri te stadiumi “Liman Gega”. Duke përfshirë këtu dhe disa rrugica të lagjeve të cilat janë në këtë rrafsh rrugor. Vlenë të theksohet që gjatë këtij viti kemi arritur të i bëjmë disa rrugë alternative siç është rruga mbrapa stacionit të autobusëve. Një tjetër angazhim i yni gjatë këtij viti ka qenë dhe dhënia e qelësave për 10 familje në kushte të rënda ekonomike të cilëve ju kemi ndërtuar në bashkëpunim me organizatën “Qatar charity”. Kur jemi te bashkëpunimi kemi nënshkruar dhe një marrëveshje me organizatën “Qatar charity” për ndërtimin e qendrës së mjekësis familjare në Kijevë dhe presim që javën e ardhëshme të fillojë tenderi.

kanë vazhduar vizitat në shtëpi për të gjithë qytetarët që kanë nevojë dhe ju kemi ofruar shërbime mjeksore pacientëve të cilët kanë pasur nevojë. Po ashtu gjatë vizitës time në Komunën Mulegns në Zvicër, kjo e fundit na ka sjellur 5 mjete motorike për pastrimin e rrugëve dhe trotuarëve, duke përfshirë këtu dy automjete për fshirjen e rrugëve.

Kemi amruar shtëpinë e veteranëve dhe muzeun e UQK-së pranë varrezave të dëshmorëve në Malishevë. Gjatë muajit të festave gjatë verës kemi pasur nderin që të kemi musafir nga SHBA ku Komuna jonë i ka shpallur qytetar nderi.

Gjithashtu kemi pasur bashkëpunimin e fondit për efikasitet elektrik për renovimin e objektit social 01 në Malishevë. Këto punime janë në fazën finale në muajin Qershor bëhet dorëzimi i punimeve nga Kompania.

Kemi vazhduar me subvencionimin e qumshtit me 0.03cent për litër për të gjithë fermerët të cilët

dorzojnë qumësht në pikat grumbulluese.

Gjithashtu organizimin e ditës së qilirimit të Malishevës, organizimi i festivalit “Oda e Llapushës”, organizimi i mbledhjes me etno grupin, si dhe festivali “Mal Fest”.

gjithashtu kemi bërë kontrata për shërbime transportuese për nxënësit të cilët vijojnë mësimet në shkollat fillore të mesme dëshmorët e Kombit në Ngucat, Hasan Prishtina në Tërpez, Ismet Jashari në Temeqinë, në fshatin Panorç, në Kravasari, në Janqist dhe në fshatin Shkozë.

Bashkëpunimet edhe gjatë vitit 2024 Komuna jonë nuk ka qëndruar heshtur dhe kemi bërë disa angazhime, mirëpo me mundësinë e përkrahjes për projektet zhvëllimore për Komunën tonë kemi zhvilluar disa takime me disa nga Minsitrit që lidhen ngusht me fushën e degëve tona. Dua të theksoj që deri më tani një bashkëpunim deri diku korrekt kemi pasur me Ministrin e mjedisit, planifikimit hapsinor infrastrukturën dhe Ministrin e kulturës. Në listën e disa kërkesave të cilat na kanë përkrahur për realizimin e projekteve tona janë bashkëfinancimi në tribunën e stadiumit, dhe rruga për te ujvara e Mirushës e cila është ende në procedurë të tenderimit. Kemi adresuar dhe shumë kërkesa të tjera të cilat akoma nuk po gjejmë përkrahje nga institucionet qëndrore apo më mirë themi nga qeveria e Kosovës. Si për shembull zgjerimi i rrugës në drejtim të fshatit Banjë në hyrje të autostradës, renovimi i rrugës Malishevë- Kijevë, faza e dytë e projektit të parkut Mirusha, gjithashtu një angazhim të madh kemi bërë dhe në parkun e donatorit vendor ndërkombëtar. Ndër hapat të cilët i kemi marrë në funksion të kësaj janë: kam nënshkruar një marrëveshje me Komunën e Haraqinës për të konkuruar së bashku në programe të ndryshme ndërkombëtare në interes të dy Komunave.

Kemi bashkëpunim dhe me organizatën Katar Charity po ashtu dhe me Islamic Relief Kosova për përkrahje me paisje bujqësore. Janë dhe shumë projekte të tjera të cilat janë realizuar gjatë vitit 2024, secili projekt është më i rëndësishëm se tjetri për të mos marrë shumë kohë nuk do të i lexoj të gjitha por gjithsesi janë të paraqitura te raporti të cilin e keni ju para jush. Varësisht prej drejtorëve përgjegjës ju mund ta adresoni ndonjë qështje të caktuar dhe janë Drejtorët prezent që mund të ju ofrojnë përgjigje. Këto janë disa pika përmbledhëse e asaj pune të madhe të cilën e kemi bërë si qeverisje Komunale gjatë këtyre viteve. Lidhur me qështjen e të hyrave dhe shpenzimeve si dhe kontratat publike të gjitha të dhënat i keni në fund të raportit. Me punën tonë që tri vite radhazi jemi më të mirët në Kosovë sa i përket investimeve kapitale. Në këtë rast dua të ju falenderoj të gjithëve pavarësisht bindjeve politike të juaja, Kryesusin, pjesën e ekzekutivit, Drejtorët, administratën Komunale të gjithë ata të cilët na përkrahin dhe na mbështesin në projekte tona të mëdha për Malishevën urbane. Jamë plotësisht i vetëdijshëm dhe ndihem keq që investimet në qytet na kanë pamundësuar të investojmë më shumë dhe aq sa e meritojnë qytetarët tanë në fshatra. Ju garantoj që periudhën e ardhëshme do të jetë kryesisht ndryshe dhe do të kemi më shumë mundësi që investimet tona të i shtrijmë sa më shumë dhe në fshatra. Ju falenderoj për vëmendjen tuaj në këtë prezantim dhe me shumë kënaqësi i mirëpres të gjitha sygjërimet. Faleminderit shumë!

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Faleminderit Kryetar, e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Urdhëro, Valjetë Hoti!

Valjetë Hoti (anëtare nga PDK): Kryetar faleminderit për elaburimin e këtij raporti, unë këtë raport e kam lexuar dhe i kam bërë një krahasim me raportin e vitit 2023, me bindje të plotë them që 70% i përmbajtjes së raportit të vitit 2024 është copy-paste nga raporti i vitit 2023. Llogaritet

që përgjatë një viti nuk kemi pasur progres real dhe kemi pasur munges transparence. Kur kemi munges transparence e dim që kemi keqpërdorime dhe keq menagjim. Nuk po tham që komplet por një pjesë ka qenë e gjitha copy paste, po ndalna të Drejtoria për shërbime publike në raportin e vitit 2023 keni thënë që projektet të cilat janë realizu për punët të cilat janë përfunduar në vitin 2023 janë hap 75 bunar në bashkëpunim me shoqatën Katar charity që ka qenë në bashkëpunim me Komunën, e keni dhe ndërtimin e shtëpive me të njëjtën shoqatë. Pastaj është zbatimi i masave ku 90% është financimi nga FKE ndërsa 10% nga Komuna. Strehimi i përkohshëm i familjeve si dhe largimin dhe pastrimin e mbeturinave inerte. Si ka mundësi që të njëjtat projekte të njëjtat punë të cilat janë përfunduar në vitin 2023 me pika dhe presje me u përfundu dhe në vitin 2024.

Drejtorja e inspektoriatit kur e kam lexuar raportin e kësaj Drejtorie e kam vërejt që në tri raste ka cek gjopa prej 200E ndërsa një rast 500E, dhe shumë raste të tjera janë cek që janë shqiptu gjopa dhe nuk ju është cek vlera e tyre. Në bazë të kësaj po del që dhe kjo Drejtori ka gjeneru të hyra dhe kishte qenë mirë me pas një pasqyr të hyrave që janë gjeneruar brenda vitit 2024. Drejtoria për Arsime përveq aktivitetet të realizuara sipas planit të veprimtari i cili që është e kuptueshme që organizimet, aktivitetet ato të cilat lidhen me data nuk kanë qare pa u mbajt në qdo vit. Mirëpo po flas për disa kërkesa dhe një pjesë ku Drejtoresha e ka cekë që DKA-ja ka shpall konkurs për plotësimin e mbi 20 pozitave të njëjtën e kemi dhe në raportin e vitit 2024. A nuk janë plotësuar ato pozita në vitin 2023 dhe kanë mbet të hapura për vitin 2024 apo qfarë ka ndodhë? Rasti i njëjt është dhe me kërkesat e Drejtoreshës kur i krahasojm të dy raportet janë të njëjta dhe bie në përfundim që ato kërkesa nuk kanë mundur të dalin prej zyres së Drejtoreshës asnjë her.

Drejtorja për urbanizëm janë projektet dy vjeqare, por në raportin e vitit 2023 e ka cek që janë projekte dy vjeqare projekte të vitit 2022-2023. Në raportin e vitit 2023 e ka cek prap që është projekt dy vjeqare 2023-2024. A janë projekte që meritat shkojnë për vitin 2023 apo për vitin 2024? Sot e ki dalja në teren apo përgaditja e paramasave për punimin e ndriqimit publik dhe mkitëmbajtjen në fshatra si dhe 15km kablo të shtruar. Prej vitit 2023 këto 15km kablo nuk kanë ndryshuar.

Dalja në teren dhe përgaditja për fillimin e punimeve dhe renovim të kanalizimit të ujërave të zeza të kolektorit kryesor në fazën e parë. Njëjt e keni dhe në vitin 2023-2024 nuk ka pasur asnjë progres në lidhje me këtë projekt.

Dalja në teren dhe përgaditja vazhdimi i ndërtimit i zhyshësoreve njëjt e keni si në vitin 2023 dhe në vitin 2024.

unë kisha kërkuar prej jush pasi punët e mira qenkan përfunduar por meritat dhe lavdatat a shkojnë në vitin 2023 apo në vitin 2024?

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati(anëtar nga LDK): Përshëndetje për të gjithë!

Dua të ndërlidhem fillimisht me pjesën fillestare të raportit ku përshkruhet problemi me energjinë elektrike, ku ceket që gjatë verës 2024 ka filluar zbatimi i projektit për vendosjen e kablove kualitative me një kosto rreth 1,000,000.00E që nuk e ka askush në Evropë. Dua ta pyes Kryetarin dhe pjesën e ekzekutivit meqenëse kjo pjesë është në raport a e ka blerë Komuna këtë kabell apo KEDS-i, sepse sa di unë është përgjegjësi e KEDS-it. Pjesa ku e cekë Kryetari ku

qytetarët e kanë mirëkuptuar këtë, unë mendoj që nuk e kanë kuptuar dhe nuk duhet me kuptu këtë gjë sepse qytetarët kanë vuajtur për energji elektrike dhe Kryetari dhe Komuna është përgjegjëse për këtë gjë. Ajo që po më brengos është që lavdatat po i merrni kur po vjen puna që nuk ka rrymë po thu që nuk është përgjegjësi e imja.

Te qështja e furnizimit me uj Kryetari e ceki një organizat që ka dashur të dhuroj fond dhe nuk e ka përkrah këtë punë niveli qendror. Besoj që do të duhej me pas një komunikim më intensiv dhe nuk ka pasur nevojë për kredi, por është dashur nga pjesa e suficitit që vazhdimisht ka niveli qendror me ja dhënë Komunës së Malishevës.

Te realizimi i projekteve sheshi dhe parkingu nëntokësor janë dy projekte madhore dhe ne si LDK i kemi përkrahur, jemi të kënaqur me këto projekte por me disa vërejtje ku nuk ka pasur mjaftueshëm rrugë alternative gjatë asaj kohe për disa biznese ku janë penalizu që nuk ka pasur lëvizje. I gjithë buxheti ka shkuar në këto dy projekte ka pasur dhe projekte të tjera të infrastrukturës rrugore, kanalizimeve, trotuateve në fshatra, po thuajse asnjë projekt që delegatët e LDK-së i kanë propozu në fshatra të Komunës së Malishevës asnjë nuk është zbatuar. Edhe nëse është përfunduar ndonjë është bërë në bazë të bindjeve të dikujt nga ekzekutivi.

Te qështja e shpjegimit të këto projekte shpesh herë si justifikimi është përdorur janë projekte dy vjeqare, por ato të cilat janë votuar në vitin 2022 nuk janë përfunduar ende, tani jemi në vitin 2025.

Te qështja e subvencionimit të qumshtit me 0.03cent për fermerët e Komunës së Malishevës unë kam biseduar me tre fermer të cilët i njoh dhe në bazë të fjalëve të tyre vetëm një her ka pasur thirrje për aplikim dhe kanë aplikuar gjatë vitit 2023 për vitin 2022. Pastaj nuk ka pasur më as ndonjë pages apo ndonjë thirrje për aplikim. Në raport të Drejtorisë së bujqësisë ceket që janë aprovuar dhe tani disa por për qështje përmbarimore nuk janë paguar ende. Mendoj që duhet me gjetë mënyren me i pagu sepse ka qenë premtim elektorale i Kryetarit të Komunës për me marrë besimin e qytetarëve për Kryetar Komune.

Te pjesa e numërimit të projekteve të përfunduara është dhe dalja në teren dhe përgaditja e paramasave për asfaltimin e rrugëve në fshatra. Në fshatin Turjak tri her janë dalë i kanë bërë matjet por asnjëherë nuk e kanë përfunduar asnjë projekt. Po ashtu dhe në fshatin Lumishtë, Banjë, Shkozë dhe fshatra të tjera.

Sa i përket renovimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve lokale unë kam qenë dëshmitar kur njerëzit kanë mbyllur gropa qoftë para bizneseve të tyre sepse disa gropa me të vërtetë janë aq të thella sa që mundet me shkakto jo vetëm dëme materiale por dhe fatalitet. Mirëmbajtja vetëm në letra ekziston por praktikisht shumë pak ose fare nuk ka pasur mirëmbajtje të rrugëve.

Te pjesa e rregullimit të shtratit të lumit në të dy anët e urës te pjesa e tranzitit është cekë sepse e ka financu granti i performancës këtë projekt. Kur është sjellë propozimi që kjo pjesë e financimit të përfshihet në buxhet dhe kur e kemi shqyrtuar dhe kemi vendosur që ky fond të orientohet te pjesa e Lumit Mirusha. Këto para janë destinuar pa pyetur kuvendin.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryetar për elaburimin e raportit por dhe për punët e mira të cilat na i paraqite në këtë raport. Unë dua ti veqoj tri nga këto pika që konsideroj që janë më të rëndësishme që Kryetari i Komunës së Malishevës së bashku me stafin e vetë por dhe me neve si Kuvend ka arrit me i realizu. Ajo më kryesorja është liri i

hapsirave publike që ka marrë vlerësim jo vetëm prej qytetarëve të Komunës së Malishevës por dhe në debate televizive. Një qeveri e mirë matet me aftësinë e saj për me shpenzu buxhetin për investime kapitale. Por një qeveri ende më e mirë është kur arrin me shpenzu buxhetin e vetë për investime kapitale dhe nuk e lejon me kaq por shfrytëzon mundësinë me gjetë bashkëpunime me donator të ndryshëm për me i plotësu nevojat sepse të gjithë e dimë që gjithë kemi pasur dhe do të kemi në të ardhmen që nevojat tona do të jenë gjithë herë më të mëdha se sa mundësitë financiare. E falenderoj Kryetarin që ka gjetur bashkëpunime të ndryshme qoftë me organizatën Qatar charity me islamik relief Kosova, dhe e inkurajoj me gjet dhe donator të tjerë. I ceki Kryetari sfidat me rrymë dhe ujë zakonisht në ato qështje të cilat nuk mjaftojmë vetëm në përdorim bashkëpunime ndërinstitucionale, ka pengesa qoftë nga institucionet qeveritare që është qeveria e Kosovës apo dhe ndërmarrje të ndryshme siq është me rastin e ujit. Ajo që është e rëndësishme të theksohet që punë të mëdha janë duke u përfunduar, ka projekte dy vjeqare, ka projekte tri vjeqare. Dua të përmbylli me një fjalë nëpër kuvende politike qoftë nacionale qoftë lokale siq jemi në gjithmonë anëtarët e Kuvendit e ndan poziten me opozit, por për mua pozicioni më i pa dinjitetshëm është kur rrin me një këmb në pozit me njëren në opozit. Aty ku e ke interesin rrin në pozit aty ku dëshiron me shfrytëzu del në opozit.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryetar për elaburimin e raportit, dhe të gjitha atyre angazhimeve, përpjekjeve dhe punëve masive të cilat janë bërë në Komunën e Malishevës. Nuk është thjeshtë një raport, ata të pa bindurit ndaj raportit i tham dil në dritare shihne vetë nuk ka nevojë me fol shumë. Sa i përket qështjes së rrymës Kryetari e ka parashtrur këtu e kujt është Kompetenca. Në njëren anë thotë që nuk ka nevojë me cek që u bëmë me kablo të re në standarte perëndimore, dhe në njëren anë e cek që pse nuk kemi rrymë ki fajti ti Kryetar. Është mirë me definu këtë qështje në qoftëse je ti fajtori për rrymen atëherë je meritator për atë kablo. Nëse nuk je fajtori për rrymen dhe KEDS-i e ka sjellë kabllo.

Te burimi i financimit për rregullimin e ujit të pijshëm përkatësisht lidhjen me Radoniqin, nuk e ka nënshkruar ministri i financave një letër garancion, e ti e cek është dashur prej suficitit qeveritar me mbulu këtë. Sa i përket votimit të sheshit ne jemi partner në koalicion dhe është dashur ju ta votoni. Për me votu këtë disa projekte keni ngulu këmb si domos ti i nderuar ti Driton që e ke cek që nuk e voton sheshin nëse nuk hin një rrugë e caktuar. Komplet 1.000.000E i ke sjellë në një rrugë 50m.

Sa i përket subvencionimit të qumshtit, i nderuar cila Komunë tjetër e ka subvencionimin e qumshtit përveq niveli qëndror që e ka subvencionimin e rregullt asnjë tjetër nuk e ka.

Sa i përket gropave unë e di që gropat mbyllen ose eliminohen por nuk mirëmbahen.

Sa i përket performancës, unë sa e di granti i performancës nuk ka ardhë asnjëherë në kuvend me u votu si projekt sepse nuk mundesh me zgjedh. Është një qëndrim kontradiktor në mes fjalëve.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Ka kërkuar replik urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati(anëtar nga LDK): Është brengosëse që sa herë unë dalë dhe gjej vërejtje të argumentuara në lidhje me raportet që i sjell kush do qoftë nga ekzekutivi, Halili edhe Valoni dalin dhe luajn lojë fjalësh. Secili del dhe fletë me fjalët e veta nuk ka nevojë me u përta dhe me tregu qfarë kanë kushtëzuar. Kurrë nuk do ta kisha votuar asnjë projekt sikur ta dija që Kryetari i

Komunës dhe ky ekzekutiv na trajtonë në formë jo të dinjitetshme si partner të kualicionit. Valon ti ke qenë nxënësi i imi dhe nuk kam nevoj për asnjë leksion dhe Halil po më vjen mirë që nuk ke argumente të tjera me më kundërshtu vetëm këtë që e cekë herë në pozitë herë në dispozitë. E drejta ime është me dhënë kritikë, rekomandime dhe me kërkim informata shpesh, më njohin të gjithë asnjëherë nuk kam dalë me tendencë por gjithmonë kam tentuar me sjell argumente.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro replikë, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Nëse ti mendove që ke me tendencë në rregull, atëherë dhe e jona paska qenë me tendencë. Na argumente kemi që granti i performancës nuk vjen në Kuvend, argument është që ke thënë që nuk e voton sheshin nëse nuk të shtrohet rrugë 50m. Pjesa tjetër i nderuar realisht të respektoj si profesor por këtu jemi në kuvend po bëjmë përplasje argumentesh nuk do të thotë që ti e konsideron një argument i yti është i paprekshëm.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj(anëtar nga VV): Faleminderit Kryetar për prezantimin e raportit. Roli ynë si asambleist ka qenë qoftë dhe kritikë kur i kemi bërë gjithmonë me qëllimin më të mirë me përmisur secilën punë qoftë të ekzekutivit në interes të qytetarëve. Vlersojmë shumë faktin që në fund të paktën deklaritikisht Kryetari e qmon këtë angazhim tonin si asambleist. Mirëpo ajo që më bie në sy dhe që pajtoj me kolegën parafolëse Valjeten, shumica e projekteve që janë të shënuara në raportin e vitit 2024 janë të bartura pa ndonjë ndryshim prej vitit 2023.

Sa i përket investimeve kapitale është e vërtetë që Komuna e Malishevës renditet e para për sa i përket realizimit të buxhetit mirëpo nuk duhet me harru faktin që komplet investimet kapitale kanë qenë të orientuara në dy projekte, kanë qenë dy projekte madhore të cilat e kanë marrë me 90% të investimeve kapitale për këtë arsye del me këtë renditje. Mirë që po përfundojmë më në fund sepse në shumicën e fshatrave kemi pasur 0 investime kapitale. Kritikë jonë është që shumë projekte janë në projekt-buxhet dhe vazhdojnë me u bart prej buxhetit në buxhet dhe nuk realizohen. Përse nuk zbatohen këto projekte të paktën ato të cilat futen në projekt-buxhet me gjetë zbatueshmëri.

nëse kritikohet niveli qëndror për mos mbështetje në projekte të caktuara unë jam kritik, nëse ka kësi projekte të cilat nuk mbështeten ne japim kritikën. Por është mirë të paktën në ato projekte të cilat ke gjetë mirëkuptim dhe ke gjetë mbështetje të paktën me thënë që kanë qenë projekte të përbashkëta, psh u cek nga Kryetari tribuna e stadiumit dhe nuk u cek që ka qenë bashkëfinancim i nivelit qëndror. Të paktën me modesti me cekë që keni qenë në bashkëfinancim me nivelin qëndror.

Te drejtorja e Arsimit shumë shkolla kanë pasur probleme me sistemin e ngrohjes. Po ashtu shumë shkolla vazhdojnë me pas mungesë të kabinetëve. Këto janë vërejtjet tona dhe shpresojmë për më mirë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit Lima!

Hamit Lima(anëtar nga LDK): Unë sa i përket raportit të Kryetarit nuk dua të mirrem, unë te një raport më heret e kam diskutuar në KpF, projekt buxhetin e par të vitit 2022 kur e kemi votuar i kemi nda mjetet për rrugën të cilën lidh Banjën me Lladrocin afër 300,000.00E. Në vitin 2024 në vend që të përfundohet neve na është ardhë ridestini në shesh. Në KpF kam diskutuar disa

herë ku mbetën 250,000.00E, sot po kërkoj nga Kryetari ku mbetën 250,000.00E?

U cek bashkëpunimi me Chatar, por tregonum ju sa manipulimet i keni bërë njerëzit që kanë nevojë nuk ikeni mbështet por ata të cilët i kanë tri ose katër rroga kjo është shkelje.

Te lirimi i lumenjëve Kryetari në Banjë i ka marrë votat në bazë të këtij premtimi kur e ka thënë “do ti lirojmë lumenjtë ky objekt në mes të lumit këtë do ta rënojmë”. Sa i përket kualicionit që e ceki, kualicioni ka qenë dhe ju këto projekte i keni bërë fal kualicionit me LDK-në, sepse që 10 vite këto projekte nuk keni mundur me i shty përpara. Jam i bindur që në shtatorin e ardhshëm LDK do ta udhëheq Komunën e Malishevës.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati(anëtar nga PDK): Te raporti i Kryetarit ajo që ke thelbësorja i analizuar në mënyrë konkrete e ceki Valjeta, por po ndalem në pika të shkurtëra. E gjithë kjo lavda që po bëhet për këtë projektin Malisheva urbane, që Kryetari tha po mirëpritet prej qytetarëve unë konsideroj që nuk është mirëprit nga qytetarët sepse qytetarit i ka ardhë te hunda me këtë kaos dhe me këto punë të cilat janë duke u bërë. Nuk po shoh ndonjë interes të madh të qytetarëve që po bëhet kjo humner dhe komplet investimi kapital po shkon në këtë humner që ju po e quani projekt urbanistik. I gjithë buxheti është shëndrru në beton dhe armatur dhe ju po e vlerësoni që keni dalë Komuna me shfrytëzimin e buxhetit 100%. A i keni parë paknaqësit e qytetarëve që 44 fshatra kanë mbetë anash dhe nuk është bërë asnjë investim minimal që 4 vite. Unë nuk e konsideroj si vlerësim apo mburrje të menaxhimit të buxhetit por e konsideroj që është duke u bërë një gabim dhe një maltretim i qytetarëve për vite me radhë, sidomos me projektin që po e quani ju projekti gjigant. Ajo qka më bëri me kesh tani po e shoh që ka fillu fushata në mes partnerit të kualicionit. Unë dua të ja bëjë një pyetje kolegëve të LDK-së, kur bëhet marrëveshja me partner me bashkëqeveris qiten gjërat dhe projektet në leter dhe të gjitha gjërat bëhen për me i shty projektet përpara. Ju që 4 vite nuk ka pas seancë që nuk jeni vonuar ka gjysë ose apo një orë, duke bërë pazare shtima gruan në punë apo motrën kjo ju ka preokupu juve dhe tani e keni kuptuar që ka qenë gabim, sepse nuk ka pasur qështje parimesh por ka pas qështje punsimesh. Gabimet dhe dështimet pranon bashkë, sepse listen e keni pas të përbashkët Drejtorit i keni nda qysh jeni marrë vesh.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati(anëtar nga LDK): Ndoshta është një shkëndi e përafrimit të Albanit me Nismën sepse ky po na kritikon neve që paskemi punësuar, Alban nëse din ndonjë punësim që unë kam pasur sepse unë bëra diskutim askush tjetër. E din shumë mirë që unë në qdo seancë e kam cek që nuk po kryhen projektet në fshatra, kritika ime kryesore ka qenë mos përmbushja e investimeve në fshatra. Sot Albani bën propagandë këtu.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro replik, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Me Malisheven urbane i ka fitu zgjedhjet Kryetari, Alban dhe do të i fitoj prap.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije Bytyqi!

Rukije Bytyqi(anëtare nga Nisma Social Demokrate): Përshëndetje për të gjithë!

Shumë projekte janë zhvillu sidomos në fshatin Turjak është ndërtu një shkollë shumë moderne. Gjithëashtu dhe rruga Turjakë- Carravranë, rruga në lagjen e Mirditës janë përfekt të zgjeruara të ndërtuara mir. Ka gjëra të cilat duhet të i vlersojmë, sidomos kur shkoj në ambulanc me i kry shërbimet mjeksore, unë shoh një ambulanc me standarte po thuajse evropiane që nuk i mungon asgjë. Qerdhet janë duke funksionu shumë mirë nuk ka asnjë kërkes për qerdhe që nuk plotësohet. Shkolla në Panorë që e ceki Albani edhe kjo shkollë u finalizu në këtë mandat, kështu që ka shumë gjëra të mira me pa vetëm kqyrni pozitivisht dhe shihni gjëra pozitive jo vetëm ato negative. Nuk mundet mbrenda një mandati me i plotësu të gjitha ëndrrat të cilat i kemi. Kryetar të uroj dhe 4 vite dhe jam e sigurt që e ke të fituar.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Një raport pune një vjeçar që ka përkushtim të qeverisjes Kastrati e cila ka dëshmuar vullnetin për zhvillim, transparenc dhe afërsin e qytetarëve të Komunës së Malishevës. U cekën investimet në infrastruktur, kujdesi për mirëqenien sociale, mbështetje për arsim dhe shëndetësi ishin këto disa nga shembujt e rezultateve konkrete të qeverisjes Kastrati. Kësaj qeverisje që po i jep Malishevës një drejtim dhe një vizion të qart. Ne me këtë ritëm dhe këtë përkushtim kemi besim që shumë projekte të rëndësishme të cilat nuk kanë mundur të realizohen do të vazhdojnë të realizohen për të mirën e qytetarëve.

U cek energjia elektrike Kryetar e di që je i njoftuar por po e ceki një kërkes të cilën tkam njoftuar që janë tri familje të fshatit Ngucat të cilat kanë munges të tri fazave është lagjia Elshani, Gashi dhe Zabelaj. Kemi bërë kërkes në KEDS dhe jemi takuar me juve Kryetar por zgjidhje nuk ka ju lus që këtë kërkes ta shtyni përpara.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Ju falenderoj për kontributin të cilin e dhatë me kaq e mbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Kryetari dëshiron të i jap përgjigjje pyetjeve të cilat u bënë.

Kryetar i Komunës-Ekrem Kastrati: Kritika është vyrtyti më i lart i njerëzimit dhe kush do që jep kritik me kuptim ajo është gjithmonë e mirëseardhur.

Mungesa e transparencës, nuk besoj që kemi mungesë të transparencës nuk jemi Komunë që kemi dalë keq, shikoje raportin e fundit të transparencës që mat transparencën e të gjitha Komunave dhe shikoje se ku renditemi. Projektet të cilat po i ceki janë të njejta dy vjeqare në rast që kemi fillu në vitin 2024 i kemi përmbil këtë vitë. Nuk ka projekte të cilat fillojnë në vit dhe mbarojnë po atë vit. Kosto e kabllos na e kemi marrë prej KEDS-it është kablo e parë që është përdor në këtë pjes të ballkanit vendor, kështu kanë thënë ekspertët dhe ju besoj atyre. Të gjithë e dim që qdo kush që punon ka kritika, ka të metat e punës së vet, përfekt është veëm zoti dhe qdo kush ka gabime por po përpiqemi që këto gabime me qenë shumë më të vogla. Qështja e ujit Dritoni e ceki që qeveria i jep parat ti duhesh me shku me i marrë, se jam Kryeministër me shku me i marrë, e din shumë mirë që ato para menagjohen prej qeveris. Veton Alban Krasniqi ka qenë asambleist këtu, dhe ka qenë këshilltar i ministrit i punve të mbrendshme dhe kam pasur takime për projektin e ujit por nuk kemi pasur mbështetje prej tyre. Ju kam thënë që kam bërë përpjekje por nuk kemi marrë mbështetje prej tyre. Ne mundemi krey buxhetin me vendos te uji

por prap nuk mundemi me marrë prej sistemit të radoniqit me sjell këtu, sepse ai ujë është në territorin e Komunës së Gjakovës e menagjon qeveria e Kosovës. Unë nuk guxoj me bërë ndonjë grop apo ndonjë hap aty pa lejen e qeveris. Të gjitha këto janë ato të cilat na kan hendikepu. Faleminderit shumë për durimin e juaj dhe besoj që këto probleme do të i rregulloj së bashku.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Drejtoria e Arsimit dëshiron të shtoj diqka.

Sabit Berisha(shëf i Drejtorisë së Arsimit): Sa i përket raportit të Drejtoris komunale të Arsimit, raporti te Drejtoria e Arsimit ndryshojnë shumë, gjatë këti viti Drejtoria e Arsimit ka pasur shumë rezultate në të gjitha fushat. Sa i përket konkursit është numri 20, mundet me qenë numër 20 dhe vitin e ardhëshëm për arsye të mësidhënsit dalin në pension, ka dhe që e kan lëshuar punën me vetdëshir, për arsye të problemeve shëndetësore, lehonis etj. Të gjithë janë këta faktor që ndikojnë, dhe Drejtoria e Arsimit është e obliguar që të hap konkurs. Sa i përket kërkesave ato janë të ngjajshme për arsye se ashtu janë nevojat në shkolla tona. Rezultatet në punën e Drejtoris Komunale të arsimit nuk jan në nivelin e lartë por besoj që kemi bërë shumë dhe bësoj që së bashku të japim kontribut dhe ta rrisim cilësin e arsimit në Komunën tonë. Kemi pasur problem me ngrohje për arsye se kemi pasur një ankes ndaj operatorit dhe kjo na ka marrë koh por nuk do të thot që i kemi lënë shkollat krejt, jemi munduar ashtu siç kemi mundur që nxënësit të mos na mbesin pa ngrohje.

Sa i përket paisjeve të kabinetit unë me përgjegjësi të plot ju them që shumica e shkollave janë të paisura me kabinete, për arsye se mundësia për të krijuar kabinete është sepse mësimi po mbahet me një ndrrim dhe hapsira ka të mjaftueshme. Aty ku mësimi bëhet në dy ndërrime është problem sepse nuk kemi vend që ti krijojmë këto hapsira. Shpresoj që gjatë këti viti do të parashohim që të kemi në shumicën e shkollave kabinete të cilat ju shërbejn nxënësve për të mirën e tyre.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Fadil Shala nga Drejtoria për shërbime publike!

Fadil Shala(Zyrtar nga Drejtoria për shërbime publike): Përshëndetje për të gjithë!

Disa asambleist shprehen disa shqetësime që janë bërë copy-paste të dhënat në raport, normalisht që janë të përfshira në vitin 2023 për arsye se në atë vit janë dërguar memorandumet, janë zhvilluar procedurat dhe te disa kan fillu dhe procesi i kryerjes së punimeve. Në vitin 2024 një pjes e tyre janë kryer punimet, është hap pranimi i projektev teknik. Nuk mundem pa e cekur bashkëpunimin e sinqert me organizaten chatar e cila kryesisht ka qenë e fokusuar në realizimin dhe plotësimin e kërkesave të qytetarëve, kërkesa për hapjen e puseve për ujë. Ju kemi ndihmu ne si Komunë 10% të shumës e cila ka qenë memorandum bashkëpunimi me shoqaten. Ndjekse e gjithë procedurës nga vizita në teren deri në konfirmimin e pranimi të kërkesës ka qenë kryesisht në bazë të kritereve të cilat i ka pasur organizata. Nuk pranoj që tha Hamiti ka pasur keqpërdorime nëse dyshon ky që ka pasur keqpërdorime janë organet kompetente dhe mund të i paraqet.

Gjithëashtu dua të i falenderojë që kan qenë dhe përkrahës qoftë me dhënie të pakove ushqimore, paisje që kanë qenë të bujqësis, dhe tani në fund kemi bashkëpunimin i cili ka qenë në vitin 2024 që ka filluar si bashkëpunim për fillimin e ndërtimit të QMFsë në Kijevë e cila tani është konkretizuar është zgjedhë operatori. Gjithashtu e ceki dhe qështjen e banimit social ku do të jetë tema qështja e planit të veprimi.

Sa i përket masave

zbatuese të energjis si projekt i tillë ka filluar në Maj të 2023 ku jemi në mesin e 10 Komunave të para që e kemi implementu si projekt, jemi Komuna e dytë. Për arsye të procedurave, ankesave të organit të prokuroritë memorandumit i bashkëpunimit është nënshkruar në fillim të vitit 2024. Besojmë që shumë shpejt përfundimi i tyre do të përfundojë mbrenda muajit Qershor.

Hamit Limaj (anëtar nga LDK): Kryetar përgjigjju pyetjes se ku kanë shkuar 250,000.00E kur ndahen mjetete për një rrugë të caktuar nuk guxojnë me kalu pa u sjellë në Kuvend. Sa i përket qështjes që e tha nuk ka pasur keqepërdorime, unë e kam diskutuar me Drejtorin këtë qështje dhe i kam treguar që njeri tokën ja ka ble një mërgimtar, shtëpinë ja ka ndërtuar Halil Kastrati kurse ju pusin nuk ja keni qel sa kam ndëgjuar.

Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Kryesus tu kisha lut me mbajtë orarin se ne të gjithë kemi obligime të tjera, dhe të gjithë jemi intelektual, nuk bën me ardhë këtu me fol qka ke ndëgju në kafe. Unë nuk kam ardhë me ndëgju Hamitin se qfar ka ndëgju ky në kafe, nëse ke fakte sjelli dokumentat, sjelli faktet përballu me diqka qka po ndodh jo me diqka qka ke ndëgju.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: E mbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës, për të vazhduar me pikat e radhës. A bën një konstatim të kourumit. 22 anëtar jemi të pranishëm. Vazhdojmë me pikën e radhës të cilën e bëm plotësim ndryshimin, pika 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23 Valon Mazreku ka propozuar që të i hedhim në një votim të përbashkët për arsye të natyrës së njëjt. Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Ka disa kërkesa të cilat janë nga pika 18 deri te pika të ndryshme, nuk janë të njëjtës natyr. Pika 18, kërkesa 02/166 nuk ka të bëjë me sëmundje por ka të bëjë me kompenzim të pronës që kinse po kërkon një rrugë me një kohë të caktuar, më herët ja kanë marrë pronën dhe e kanë shëndrruar në rrugë. Unë pash një mungesë të institucionit, në këtë rast të Komunës një konstatim zyrtar që këti zotriu ose parashtuesit të kërkesës i janë marrë kaq metra për ndërtim të rrugës, dhe si rezultat duhet me ja kompenzu qoftë përmes pronësimit apo këmbimit pjesën që bën ajo. Janë disa qështje të cilat duhet me ardhë në kuvend që me i pa ne, në radhë të par duhet raporti i gjeodezis dhe kadastrit se ku i është marrë ajo pronë me skica dhe komplet dosjen. Kisha propozu që pika 18 të shtyhet në mbledhjen e ardhëshme.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Meqë jemi te pika e 18 vazhdojmë me propozimin e Valonit që pika e 18 kërkesa nr.02/166 të largohet nga rendi i ditës për arsye të kompletimit të lëndës. Kush është për?

Me 21 vota për , 0- Kundër, 1- Abstenim largohet kjo pikë nga rendi i ditës.

Vazhdojmë me pikat 19, 20, 21, 22, dhe 23 janë kërkesa të natyrës së njëjt për trajtim shëndetësor të sëmundjes. Propozoj që të votohen në votim bllok të ju ndahen mjetet financiare 1500E për secilin rast. Kërkesa nr 02/25, 02/35, 02/84, 02/94, 02/118. Kush është që këto kërkesa të mbështeten nga 1500E për trajtim të sëmundjeve shëndetësore? Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Për hir të korrektsis nëse jo vitin e kaluar ka mundur me qenë në vitin 2022-2023 ku njëri prej punëtorëve të Komunës ka bërë kërkesë në KPF për me mbështet sepse ka qenë sëmur dhe nuk është mbështet nuk është futur as në rend të ditës. E ka ngrit këtë qështje dhe Labinot Gashi, tani me ardhë një kërkesë me kalu në KPF me miratu në kuvend, për një puntor të Komunës, jo që ky nuk ka të drejt jo që kërkesa e tij nuk është legjitime por jan të barabart. Unë me voten time me kriju këtë diskriminim është shumë e pa pranueshme. Më vjen keq është dashtë me u diktuar në KPF.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije Bytyqi!

Rukije Bytyqi(anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Valon e di për cilin rast je duke folur është invalid i luftës nëse nuk gaboje, ne kemi shku me shumë nga ajo pjesa për kontributin që ka dhënë. Si puntor i Komunës nuk besoj që e kemi anashkalu vetëm që ka qenë puntor i Komunës të gjitha kërkesat ne po i shqyrtojmë, por buxheti i Komunës po na pamundëson me i realizu të gjitha. Përndryshe nuk kemi pasur ndonjë tendencë që ka qenë puntor i Komunës, nuk bëjmë kurrë kesi krahasime.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi:Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Qdo seancë i kemi ka 5-6 raste, sa kam ndëgju dikujt i kemi ndihmuar para 7 ose 8 muajve ende nuk i kanë dalë, unë i ku[ro]j nëse Drejtoria e financave nuk kanë para, por nëse nuk kemi para për kaq shumë raste është mirë me diskutu këtu dhe mos të ju marojmë qef njerëzve. Ti balancojmë mundësit tona me nevojat të cilat i kemi. Me pa mundësinë një puntori të Komunës ja ndaj 10,000.00E dhe një fëmijë që është me kancer ja ndaj 20,000.00E por na nuk kemi mundësi.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ne nuk jemi duke e prishë rendin, por me mirëkuptim e kemi bërë mos me dal me debat për raste të tilla. Kur një zyrtar i Komunës po më vjen keq që duhet me cek me emër Xhevdet Mazreku i pensionuar tashmë, në vitin 2022-23 ka pasur intervenim ka kërkuar mbështetje nga kuvendi nuk e keni aprovu në KPF kryesusi nuk e keni sjellë në kuvend kaq po them. Nuk jam kundër tyre me ju ndihmu por jam kundër selektimit. Unë jam për secilin nëse Komuna ka mjete financiare unë jam me i mbështet të gjitha kërkesat të cilat kanë nevojë për trajtim shëndetësor, por jo duke diskriminuar dikë. Në fund fare nuk përfitoj as unë as ti por thjesht hijmë në gjynah me veprimin ton.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro Hamit Limaj!

Hamit Lima(anëtar nga LDK): Sa i përket kësaj qështjeje në lidhje me këtë kërkesë Valon procesvërbalet jan unë kam kërkuar për kontributin e dhënë në Komunë të Malishevës me qu në asamble si kërkesë, anëtarët e partis tëndë i ke pas kundër. Secili prej nesh ndihemi shumë keq këto kërkesë kur të vijnë sepse ka shumë kërkesa dhe raste shumë të rënda. Nuk bëjmë diskriminime, e kemi bërë me i sjell rastet me kancer në asamble për arsye me i ndihmu më shumë. Këto tjerat të cilat vijnë disa i dërgojmë te Kryetari disa ju ndihmojmë me 300E,400E disa me 500E është shumë e rëndë me qenë në atë Komision për pikat e ndihmave.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë Hoti!

Gentianë Hoti(anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Është një akuz shumë e rënd, mua nuk po më kujtohet si emër dhe nuk e di që e kam votuar kundër, asnjëherë nuk kemi votuar kundër këtyre rasteve. Ne i shqyrtojmë personat të cilët janë me kancer, nganjëherë i ndajmë dhe me moshë ata të cilët janë më të rinj i sjellim këtu, nuk është mirë dhe të ndarja e moshës sepse të gjithë janë njerëz, por nuk mundesh këtu me dal me thënë anëtarët e tu nuk e kanë votuar.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Deri tani të gjitha miratimet të cilat i kemi pasur sikur rekomandimet të gjitha i kemi pasur me vota unanime.

Driton Kastrati(anëtar nga LDK): Ne nuk mundemi me penalizuar dikënd sot pse nuk e kemi ndihmu dikënd më herët, rastet tjera të cilat vijnë jemi të gatshëm me i ndihmu pavarësisht qka punon.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: E falenderoj Drejtorin e financave e cila i ka përfunduar të gjitha obligimet e vendimeve sa i përket këtyre rasteve deri më tani, përveq ndonjë rasti që ka mundur me qenë në mungesë të ndonjë dokumenti.

Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Mendoj që duhet të kemi pak konsiderat për këta njerëz sepse të gjithë ata të cilët kanë bërë një kërkesë kanë një hall apo një nevojë. Po shoh kërkesa për ndihmë momentale të muajit Shkurt, Prill, Maj po më intereson më ditë si janë bërë përzgjedhjet, apo siç tha dhe Genta për arsye të moshës dhe sëmundjes. A ka kërkesa të tjera që priten me ardhë në kuvend?

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Po ka kërkesa të tjera, Halili tha po vijnë 5-6 kërkesa por ne nuk kemi mbajtur mbledhje dy muaj dhe po i bie dy kërkesa në muaj. I hedhim në votim kërkesa nr. 02/25, kërkesa nr. 02/35, kërkesa nr.02/84, kërkesa nr.02/94 dhe kërkesa nr. 02/118. Kush është që secilës nga këto kërkesa të ju ndahen shuma prej 1500E për trajtim të sëmundjes shëndetësore.

Me vota unanime miratohen këto kërkesa.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 04/226 datë 11.04.2025 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin fiskal 2025. Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi(Drejtor për buxhet dhe financa): Përshëndetje për të gjithë!

Si qdo vit dhe këtë vit mjetet e pa shfrytëzuara nga viti paraprak që kryesisht janë nga periudha e katër e fund vitit, pjesa më e madhe është nga të hyrat të cilat krijohen nga gjobat nga gjykata. Vlerën në total kap 338,743.92E dhe që ne kemi planifikuar ti bartim dhe ti ridestinojmë në kategorinë e kapitaleve, të mallrat dhe shërbimet arsyëja e bartjes të shumës e cekur 200,000E për rregullimin e qendrës së sheshit të qytetit të Malishevës është për arsye se në muajin shkurt lëndët përmbartimore të shujtat të mësimdhënësve nga ky projekt na kanë marrë 318,000E. Nuk do të thotë që ne me këtë pjesë mund ta mbulojmë të gjithë atë pjesë që na kanë marrë përmbartuesit por të paktën ta lehtësojmë at planifikim që kemi pasur për të realizuar në projektin e sheshit, gjithashtu dhe në pjesën e të hyrave që planifikojmë që do të kemi tejkalim në pjesën e dytë të vitit 2025. Po ashtu pasi që i kemi të kontraktuar edhe kontratat e rrugëve kemi planifikuar që

në këtë pjesë të jetë 35,743.92E dhe 50,000E te renovimi i objekteve shkollore pasi që kjo kontrat këtë vit në realizim ka përfunduar dhe nuk mund me mbulu dhe me 50,000 sepse janë rreth 100,000E për tu përfunduar kjo pjesë dhe po them nga këto dy projekte kemi lëndë përmbartimore që na kanë dëmtuar dhe na kanë marrë përmbartuesit për kontratën kolektive. Kemi planifikuar që të mbulohet kjo pjesë nga bartja e vitit 2024, gjithashtu dhe të pjesa e mallrave dhe shërbimeve janë disa obligime kemi ndarë 3,000E. Ju kisha kërkuar që të na mundsoni aprovimin e kësaj kërkesë në mënyrë që të na mundsohet realizimi i shpenzimit në këtë muaj apo muajin Qershor pasi që këto i kemi vetëm obligime.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: E hedhi në votim kush është për miratim për pikën Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 04/226 datë 11.04.2025 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin fiskal 2025. Kush është për?

Për: 16

Kundër: 4

Abstenim: 2

Me 16 vota për, 4-Kundër, 2-Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika radhës është: Shqyrtimi i raportit 3 mujor financiar Janar- Mars për vitin 2025. Urdhëro, Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi(Drejtor për buxhet dhe financa): Te realizimi i të hyrave për periudhën e të hyrave tre mujore është e specifikuar që është 19.9% por ju njoftoj se deri më sot realizimi i të hyrave vetanake ka arritur vlerën e 750,000E që sipas planifikimit është 50% për tre muaj e gjysë.

Kryesusi i Kuvendit- Argjend Thaçi: Nëse nuk ka diskutim për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë te pika e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të veprimit tre vjeçar për banim social për vitin 2025-2027. Urdhëro, Z. Fadil Shala!

Fadil Shala(zyrtar nga Drejtoria për shërbime publike): Draft-palni i veprimit është një prej dokumentave bazikë i cili kërkon bazë legjislativore në fuqi që secila Komune të ketë planin tre vjeçar të banimit social. Bazë kryesore e këtij plani është infrastruktura ligjore të cilën ju e keni vërejtur që janë dhe ligji për financimin e programeve të veqanta të banimit ligji kryesor që janë, gjithëashtu janë udhëzimet administrative mbi kriteret e përzgjedhjes së rasteve të përfitimit të banimit social, mënyrat e financimit, përfituesit, komisionete të tjera. Një prej bazave kryesore që kërkohet në këtë plan është që në kuadër të Drejtoratit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale me organizimin që ky sektor të hyjë në kuadër të Drejtorisë për shëndetësi. Për momentin është në kuadër të Drejtorisë për shërbime publike.

Ju e vërejt që ky dokument bazik shënimet i ka kryesisht të marra nga Drejtoria referente të cilat i keni në faqe të cilat i falenderojmë shumë për ofrimin e shërbimeve. Gjithëashtu janë të dhëna statistikore të cilat janë marrë nga regjistrimi i fundit të popullsisë në vitin 2011. Ky dokument njehsisë së banimit i nevojitet sidomos në të dhëna bazikë për arsye se tani Komuna e Malishevës është nënshkruar e memorandumit të bashkëpunimit të banimit social adekuat. Dua të jap një informacion të përgjithshëm kërkesat për qështjen e banimit janë në rritje sepse familjet nuk qëndrojnë në një bashkësi familjare, por kryesisht janë familje të ngushta të cilat nuk i kanë

mundësin financiare të krijojnë kushte të banimit apo nuk kanë pronë ku mund të bëhet ndërtimi i shtëpisë. Ne si Komune jemi nënshkrues i këtij memorandum i jemi në proes dhe kemi adresuar pjesën preliminiare ku kryesisht janë kushtet e fundit nga familjet ku i cekim komponentët dhe presim që mbrenda muajit Qershor të fillojë dhe implementimi, paraqitja e kërkesave zyrtare. Kërkojmë të bëhet miratimi për arsye se është dokument bazik dhe që kërkohet me legjislacion.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Falenderoj z.Shala për elaburimin dhe unë jam për me votu ashtu si është.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Për arsye të pengesave të rrjetit në transmetim në youtube jemi në transmetim në facebook.

Kush është për miratimin e planit të veprimtimit tre vjeçar për banim social 2025-2027?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 14 vota Për, 0-Kundër, 2-Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është:

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të kuvendit për vitin 2024.

A keni ndonjë gjë për të diskutuar? Nëse jo, 16 anëtar jemi të pranishëm dhe kemi kourum për vazhdimin e punimeve. Kush është për miratim të kësaj pike?

Me vota unanime me 16 të pranishëm miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika radhës është: Formimi i këshillit organizativ për kremtimin e 16 Qershorit ditës së qllirimit dhe dëshmorëve të Komunes së Malishevës. A ka mundësi nga një emër nga secili subjekt politik. Format i deritanishëm kanë qenë shefat e grupeve parlamentare, Drejtoria për kultur, rinë dhe sport, Kryesuesi i Kuvendit, dy përfaqësues nga zyra e Kryetarit dhe një nga OJQ. A shkojmë me këtë format? Kush është për këtë format të formimit të komisioni të këshillit organizativ?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 14 vota Për, 0-Kundër, 2-Abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Pika tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/523 datë:02.05.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunes për inicimin e procedurave administrative në lidhje me dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, qëllime të tregut publik, dhe interesit publik në zonën kadastrale në Carrallukë Malishevë. Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Përshëndetje për të gjithë!

Kërkesa e Kryetarit ka të bëjë me parcelën e cila gjindet në zonën kadastrale në fshatin Carrallukë, përball varrezave të dëshmorëve. Prona është publike në emër të kuvendit Komunal, qëllimi i Kryetarit ka qenë me shprehë interesin publik me dhënie në shfrytëzim afat gjatë. Me rregullu infrastrukturën dhe qëllimet kompetencat që ka kuvendi komunal njëra prej tyre është

menaxhimi i tregut publik. Operatorët të cilët janë të interesuar me hap treg publik në interes të Komunës së Malishevës. Afati është deri në 99 vite nuk do të thotë fiks 99 vite. Është pjesë e listës së pronave me dhënë në shfrytëzim, kjo është procedurë që duhet të përfundohet.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Atëherë kush është për miratim të kësaj pike të rendit të ditës?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenime: 2

Me 14- vota Për, 0-Kundër, 2-Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Krahas kësaj pike kemi bërë me formu komisionin që është pika tjetër: Formimi i komisionit vlerësues me rastin e dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike. Formatimi është dy anëtar nga Kuvendi, dy nga Kryetari dhe një nga shoqëria civile.

Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): unë në kuadër të grupit të Nismës Socialdemokrate propozoj Amrush Helshani.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Zamire!

Zamire Morina(anëtare nga LDK): Unë në kuadër të grupit LDK propozoj Arlind Morina.

Valon Krasniqi: Unë kisha propozu me qenë një anëtar nga opozita një nga ekzekutivi nga asambleja Komunale.

Muharrem Morina: Valon duhet dy nga asambleja, dy nga ekzekutivi.

Arlind Morina(anëtar nga LDK): Unë propozoj Valon Morinen!

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Tërhiqet propozimi për Arlindin.

Kush është për që anëtar të këtij komisioni të jenë Amrush Helshani, Valon Krasniqi, dy nga zyra e Kryetarit dhe një nga shoqëria civile.

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 17 vota Për, 0-Kundër, 1-Abstenim formohet ky komisioni.

Pika radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/333 datë: 17.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës përfundimi i procedurës së këmbimit të pronës publike me pronë private sipas vendimit të kuvendit nr.02/397 datë: 11.09.2024.

Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Meqenëse në bazë të titullit të shkruar në rend të ditës do të thotë që është përfundim i procedurës, fazat e mëparshme kanë përfunduar. Sikur vendimi paraprak në kuvend, raporti i vlerësimit të ministrit të financave, ligjshmëria në MAPL pra është proces në përfundim të procedurës kisha kërku me hedh në votim.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Kush është për miratim të kësaj pike të rendit të ditës?
Për: 16

Kundër: 2

Abstenim: 1

Me 16 vota Për, 2-Kundër, 1-Abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/369 datë: 27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publik në Komunën e Malishevës.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Shkozë, Malishevë dhe Bubavec tri parcela janë me një kërkesë por të qështja e Bubavecit fletet vetëm për dy hektar dhe flitet për zonën të cilën e ka pasur pala në shfrytëzim, e ka bërë kërkesën pasi e ka pa vendimin e asambles që i jep në shfrytëzim.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kjo kërkesa e cila është në fshatin Bubavec, kërkesën e pash që është 10 hektar duhet të qartësohet mirë për një lloj aktiviteti të caktuar është hapësirë e panevojshme.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Halil vendimin keni me marrë për dy hektar, është e pa ndarë parcella por vendimi i juaj është vetëm për dy hektar. I di shqetësimet e qytetarëve të fshatit por nuk ka asnjë shqetësim, sepse fermeri i cili e ka bërë kërkesën me marrë atë parcell nuk e di unë a munda me marrë, sepse ka me u hap procedura ai ka të bëjë vetëm për fermën e vetë e cila është rreth 2 hektar. Në shkozë është një sipërfaqe e madhe është për hapje të procedurave të shpreh interesin për prodhim të energjisë solare, projekt nëse mundet me realizu. E treta është në Dragobil afër palestrës sportit është sipërfaqe 9 ari ka interesa të bizneseve me marrë në shfrytëzim kemi hap procedurat kemi hap konkurrencën kush ofron më shumë për Komunën e Malishevës ai e merr.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Meqenëse Muharremi e shpjegoi që në vendim Kryesuesi e cek 2 hektar atëherë ne po e miratojmë me 2 hektar, dhe në procesverbal e shënojmë kështu.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Fermeri i cili e ka bërë kërkesën vetë e ka në shfrytëzim më herët që i ka dhënë ish Kryetari por i ka skadur kontrata tash po kërkon me marrë përsëri. Kur e ka bërë kërkesën e ka bërë për parcell dhe të qytetarët ka kriju paknaqësi, por nuk do ta merr atë pjesë.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Ne në votim nuk mundemi me qit vetëm për dy hektar sepse është kërkesë e përgjithshme nuk është e specifikuar.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Ne në vendim e cekim vetëm 2 hektar.

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Në qoftëse 10 hektar shpallet zonë me interes të përgjithshëm dhe parashtuesi i ka kërkuar vetëm 2 hektar, qfarë ndodhë me 8 hektar tjer. A mundet dikush tjetër me bërë një kërkesë?

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Jo sepse kur bëhet thirrja publike bëhet vetëm për dy hektar.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: E hedhi në votim kush është për miratimin e kësaj kërkesë 01/369 datë: 27.03.2025?

Për: 16

Kundër:0

Abstenime: 2

Me 16 vota për, 0-Kundër, 2-Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Te kjo pikë duhet të formohet komisioni, përbërja është e njëjt dy nga Kuvendi, dy nga zyra e Kryetarit dhe një nga shoqëria civile.

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Meqë është e natyrës së njëjt unë i qëndroj propozimit të mëparshëm, Amrush Helshani!

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Zamire Morina!

Zamire Morina(anëtare nga LDK): Arlind Morina!

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Kush është që Amrush Helshani, Arlind Morina, dy anëtar nga zyra e Kryetarit dhe një nga shoqëria civile të jenë anëtar të komisionit?

Për: 17

Kundër:

Abstenim: 1

Me 17 vota Për, 0- Kundër, 1- Abstenim formohet ky komision.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/362 datë: 27.03.2025 e parashtuar nga Kryetari i Komunës për shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës nr.01350 /datë: 21.03.2025. Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): E kam lexuar këtë kërkesën të cilën e ka shenuar pala përmes zyrev të avokatit, mu duk pak e komplikuar me hap një rrugë përmes pronës private, nuk munda me kuptu qart. Kisha kërkuar nga Muharremi një interpretim.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Qështja është e komplikuar në atë kuptimin që nga ana profesionale je ekonomist por në aspektin ligjor biznesi në fjalë në mes të përcellës ka rrugën në kadastër, ajo rrugë nuk ekziston por në kadastër shenon si rrugë. Kërkon që parcellen e vet me nda pjesën private me ja bashku rrugës që është në kadastër, ndërsa pjesën e rrugës me ja bashku parcellës. Dëshiron me bërë përkufizimin e parcellës, aty gjindet një pomp e benzinës e një qytetari të Komunës së Pejës ai përmes kompanisligjore e ka drejtuar këtë kërkesë te Kryetari dhe kërkon me zhvendos rrugën. Pra ka vetëm zhvendosje, nuk ka procedur tjetër për zhvendosje përveq këmbimit kena me ja liru rrugën e me ja marrë pronën private.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: E hedhi në votim kush është për miratimin e kërkesës nr. 01/362 datë: 27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës nr.01350 /datë: 21.03.2025.

Për:15

Kundër:0

Abstenim:3

Me 15 vota Për,0-Kundër, 3 Abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika radhës është:

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të komitetit për kultur, rinë dhe sport për vitin 2024.

Atëherë pika 14 dhe 15 janë raporti dhe plani, kush është që këto dy pika të shtyhen për mbledhjen e ardhëshme për arsye se nuk është asnjë anëtar i këtij Komiteti prezent.

Në mënyrë unanime shtyhen këto dy pika.

Pika e radhës është:

Shfuqizimi i vendimit 02/478 datë: 10.01.2025 për miratimin e planit komunal për menagjimin e mbeturinave. Kush është për shfuqizimin e këtij vendimi? Me vota unanime miratohet dhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika radhës është:

Kërkesa nr.01/582 që është raporti i punës së Komisionit vlersues me rastin e udhëheqjes së procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, përmes thirrjes të interesit publik konform vendimit të kuvendit nr.02/121 datë: 08.03.2024.

Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Vendimi për dhënie në shfrytëzim afatgjatë është marrë në vitin 2024 pastaj është formu dhe Komisioni, anëtar i Komisionit jam dhe unë. Komisioni i ka zhvillu procedurat, të gjitha kërkesat ligjore rreth rregullores për qështjen në fjalë. Ka hapur thirrjen publike, parcela është marrë në bazë të vendimit nga asambleja që është marrë vendimi paraprak këtu. Parcela është në fshatin Dragobil, në lagjen pallanka kanë aplikuar tri oferta, oferta më ekonomike për Komunën e Malishevës, me proces kemi pasur kompanin “Arbri KS” e cila për 99 vite ka shpreh dëshirën që ta paguaj 99,000E për sipërfaqen që e kemi dhënë me qera. Pastaj është kompania “Ilir Begaj alfa” e cila ka shprehur ofertën për 99 vite 89,100E, ndërsa investime ka parapa 350,000.

Kompania ofertuese i cili komisioni e ka rekomandu kuvendit është Kompania ofertuese NMT Burimi Agim Morina biznes individual me seli në rrugën Imer Krasniqi në Malishevë, për 99 vite i ka ofru Komunës 128,700E vlerë investive 1,303,730E koha e investimit është 12 muaj. Sipas komisionit qikjo është oferta prej të tri ofertave që kanë aplikuar është oferta më e leverditshme. Qëllimi është vetëm dhënia e pronës në shfrytëzim, jo me qëllim ndërtimi.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: E hedhi në votim kërkesën nr. 01/582 që është raporti i punës së Komisionit vlersues me rastin e udhëheqjes së procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, përmes thirrjes të interesit publik konform vendimit të kuvendit nr.02/121 datë: 08.03.2024. Kush është për?

Për:16

Kundër: 0
Abstenim: 1

Pika radhës është kërkesa nr. 01/574 lënda kërkes për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike lokacioni me të cilin është përcaktuar ndërtimi i deponis së mbeturinave nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore në territorin e Komunës së Malishevës sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës nr.02/219 datë: 05.05.2025.

Muharrem a mundesh dhe këtu me na sqaru konkretisht për qfarë bëhet fjalë.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Asamblea në vitin 2022 ka marrë vendim ku ka përcaktu zonën kadastrale në të cilën do të përcaktohet për deponi të materialeve inerte, ajo zonë kadastrale është një zonë me sipërfaqe prej 16 hektar në fshatin Banjë. Kryetar ka kërkuar që në atë zon tani deponin se Komuna nuk mundet me menagju nuk ka kapacitet, duhet me ja dhënë një operatori i cili duhet me marrë në shfrytëzim dhe me i marrë të gjitha masat që kërkojnë sipas ligjit për me bërë deponit për ujin e materialeve inerte. Në kuadër të asaj zone, Kryetari e ka bërë kërkesen që sipërfaqja e deponis e cila është caktu me vendim të asambles të jipet në shfrytëzim afat shkurtër deri në 15 vite, për vitet vendosni ju, për vlerën e qeras për hektar e përcaktoni ju. Në kuadër të asaj asaj zone janë të propozuara nga Kryetari 2 hektar me i shpall deponi, plus 4 hektar janë të përcaktuara për aktivitete afariste në kuadër të njëjtës zonë.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë kisha propozu që qeraja minimale për hektar me qenë 300E pasi që nuk është vetëm një hektar janë 6 hektar dhe vitet maksimale në kuadër të kësaj procedurën me qenë 15 vite.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Së pari parashtuesi i kësaj kërkesë është dashur me na dhënë iden rreth afatit kohor sa i duhet. Unë mbështes propozimin e Valonit për vite, por për qera nuk e di a janë shumë 300E apo janë pak.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati(anëtar nga LDK): Nuk e kuptoj pse një kompani private me marrë pronën e Komunës për me i hudh mbetjet inerte, qfarë tarife ka me përdor ai me qytetarët e Komunës së Malishevës.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Ki të drejt prof, qështja është e rregulluar me udhëzimin e ministris së ambientit. Operatori ka me mirëmbajt me mbikqyr demolimet, tarifen ka mja caktu kuvendi Komunal me rregulloren për tarifa, taksa dhe ngarkesa. Ndërsa Drejtoria e shërbimeve publike, urbanizmit dhe inspektoriatit kan me i detyru të gjithë operatorët që kanë rrënimë dhe ndërtime materialet inerte me i qu në deponi.

Kryesus i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Po shihet që disponimi është për një qera më të lartë 500 E për hektar vjetor mirëpo afati letë jetë për 15 vite.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e kërkesës nr.01/574 lënda kërkes për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike lokacioni me të cilin është përcaktuar ndërtimi i deponis së mbeturinave nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore në territorin e Komunës së Malishevës sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës nr.02/219 datë: 05.05.2025. Afati të jetë 15 vite dhe vlera minimale e kostos për qera për hektar të jetë 500E. Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për:15

Kundër:0

Abstenim:1

Me 15 vota Për, 0-Kundër, 1-Abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Krahas kësaj pike të formohet komisioni pas kërkesës 01/575, formati është i njëjt dy anëtar nga Kuvendi, dy nga Kryetari dhe një nga shoqëria civile. Pres propozime për anëtar të Komisionit. Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ne propozojm Astrit Sertollin!

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina(anëtar nga LDK): Ne si grup propozojmë Z mire Morina!

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Kush është për që në përbërje të komisionit të jetë Z mire Morina, Astrit Sertolli, dy anëtar nga zyra e Kryetarit dhe një nga shoqëria civile.

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim:1

Me 16 vota Për, 0-Kundër, 1-Abstenim formohet ky komision.

Kush është për miratimin e kërkesës për bashkimin e parcelave publike për nevoja të fshatit Bellanic? Bëhet fjal për pacellat nr. 357, 358, 359, 360, 361, 362, 363, 364 dhe 365 që të gjitha zonë kadastrale Bellanic. Kush është për?

Me vota unanime me 17 të pranishëm miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kërkesa 02/85 datë 07.04.2025 e parashtruar nga organizata e veteranëve të luftës të UQK-së dega në Malishevë. Lënda kërkes OVL UQK- dega në Malishevë.

Përshëndetje të nderuar anëtar të Kuvendit komunal të Malishevës, OVL kërkon mbështetje nga kuvendi komunal në Malishevë për paisjen e kullës të organizatës tonë me inventar të nevojshëm për zyret që gjinden aty. Vlera që e kanë kërkuar është 5130E.

Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati(anëtar nga LDK): Do të ishte mirë që kjo kërkes të trajtohet në kohën kur bëhet rishqyrtimi i buxhetit, ose të planifikohet në buxhet sepse në qfarë forme do të ishte e mundshme përkrahja e kësaj kërkesë. Ndoshta Muharremi mundet me na shpjegu se si.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Mundet prej mallrave dhe shërbimeve sepse po i kërkojnë për inventar.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Nuk ka dyshim që askush prej nesh nuk është kundër ndihmës së kësaj shoqate por nuk e dimë sa janë mundësit financiare të Komunës dhe prezent nuk e kemi Drejtorin e financave dhe askënd nga Drejtoria e financave me ditë a ka mbet apo nuk ka mbet. Unë nuk e kam as qysh të propozojë shumë, as si ta mbështes shumë që kan kërkuar OVL. Ndoshta më mirë kishte qenë me shty për me marrë dhe konfirmimin edhe nga Drejtori për buxhet se a kan mjete financiare apo nuk kanë. Në këto kushte e kam të vështirë me vendos.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Në radhë të parë nuk është e definuar aspekti ligjor i mbështetjes së saj, sepse qdo mbështetje për një institucion tjetër sidomos për OJQ, OJQ-të i nënshtrohen një procesi të konkurimit të thirrjes publike. E dyta mbështetet nga kategoria e subvencioneve, tani si ka me u trajtu aspekti ligjor te ky rast është pikëpyetje e madhe. Ose duhet me i ble Komuna atë inventar me ja dhuru si donacion shoqatës ose përmes subvencionimit. Nuk ka formë tjetër këtu.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor): Valon përmes subvencionimit duhet thirrje publike, duhet me i ble si asete të komunës me i regjistru si asete të Komunës pastaj si donacion me ja dhënë shoqatës ndryshe nuk mundemi.

Valon Mazreku(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Të gjithë ne jemi pro mbështetjes së organizatës së veteranëve por gjithmonë në harmoni me ligjin dhe me mundësit që i kemi. Kisha propozu që në mbledhjen e ardhëshme me u trajtu dhe vjen dhe ekzekutivi na tregojnë a ka mundësi me u trajtu dhe me u realizu kjo kërkes.

Kryesues i Kuvendit- Argjend Thaçi: Propozimi i Halili është që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhëshme. Kush është për?

Për: 16


Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 16 vota për, 0-Kundër, 1-Abstenim kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhëshme.

Ju falenderoj shumë për kontributin e juaj në këtë seancë të tej zgjatur, por ishte në të mirë të qytetarëve. Me kaq përfundon seanca, shihemi në seancat e radhës.

Procesëmbajtësja
Argjend Thaçi



Kryesues i Kuvendit

Argjend Thaçi

